



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave”

në “Inxhinieri Ndërtimi ” me profile:

a) *Inxhinieri Strukturash*

b) *Inxhinieri Infrastrukturë transporti*

“Universiteti Metropolitan Tirana”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.ass.Dr. Florim Grajcevci

Prof. Asoc.Dr. Gafurr Muka

Shtator/2021

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 1

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile: a Inxhinieri Strukturash; b. Inxhinieri Infrastrukturë Transporti

Nr.		
1	IAL aplikues:	“Universiteti Metropolitan Tirana”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile: a. Inxhinieri Strukturash; b. Inxhinieri Infrastrukturë Transporti
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 497, datë 18.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6.1.	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Profili "Inxhinieri Strukturash" Urdhër QSHA Nr. 366, Datë 23.12.2019
6.2.	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Profili: "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti" Urdhër QSHA Nr. 367, Datë 23.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016, bazuar në VKA Nr. 103, datë 3.11.2015 dhe VKA 103/1, datë 18.12.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS për dy profile: a) dhe b)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE/7 PAK (66% PAE/34 % PAK)
16	Numri i studentëve (për dy vite):	67 studentë
17	Komente / të tjera:	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 2

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me Vendim Nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana" (Aneksi Nr.05, VKM e licencimit të UMT). Në zbatim të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë, UMT me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018 të ministrit përgjegjës për arsimin ka miratuar Statutin e tij, tashmë me statusin si Universiteti "Metropolitan Tirana" (Aneksi Nr.01, Statuti i UMT). Universiteti "Metropolitan Tirana", me njësitë kryesore të tij është akredituar si institucion i arsimit të lartë në dhjetor 2017 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare. Pas riorganizimit si universitet dhe miratimit të statutit të ri, UMT është akredituar, me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr.45, datë 05.07.2019. Afati i akreditimit institucional është deri në 14 Dhjetor 2022 (Aneksi Nr.13, VBA për akreditimin institucional). Aktualisht, Universiteti "Metropolitan Tirana" përbëhet nga 3 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje tre njësi bazë, të organizuara si më poshtë:

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

Fakulteti i Ekonomisë, që përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile: 'Inxhinieri Strukturash' dhe 'Inxhinieri Infrastrukturë Transporti' është hapur për herë të parë në vitin akademik 2012-2013 në zbatim të UMASH Nr. 497, datë 18.10.2012. Akreditimi i parë i programit është sipas Urdhrit të MASR Nr. 10, datë 07.01.2016, bazuar në Vendimet e Këshillit të Akreditimit Nr. 103, datë 03.11.2015, dhe 103/1, datë 18.12.2015. [Dokument, urdhër për hapjen e disa programeve MSc (Metropolitan)].

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (FIA) është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit Master Shkencorë në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile. Njësi bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit** në bashkëpunim me njësitë tjera akademike si dhe strukturave ndihmëse akademike, administrative, të cilat japin kontribut në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit (Aneksi Nr. 4, Organigrama e UMT). Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, ofron 1 program të ciklit të parë, BSc në Inxhinieri Ndërtimi, 1 program të ciklit të dytë, MSc në Inxhinieri Ndërtimi dhe 1 Program Studimi integruar MSc, MSc (PI) në Arkitekturë, si dhe 2 programe studimi profesionale dyvjeçare. (Aneksi Nr. 52, lista e programeve që ofron FIA në UMT).

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit në Vendimin nr. 103/1, datë 18.12.2015

Institucionit i rekomandohet të:

- pasurojë bibliotekën me tituj të literaturës bazë dhe ndihmëse për këtë program studimi
- vendosë e zbatojë kritere më të larta për të rritur cilësinë e studentëve në hyrje

Analiza e përmbushjes së rekomandimit a)

Për përmbushjen e këtij rekomandimi, UMT ka ndjekur një plan veprimi bazuar në politika të qarta lidhur me rritjen e cilësisë në hyrje të studentëve në programin e Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi

Ky rekomandim është përmbushur plotësisht, pasi për çdo literaturë bazë dhe ndihmëse të miratuara në syllabuset përkatëse të lëndëve gjenden në bibliotekën e UMT, në sasi të mjaftueshme kopjesh hard copy, në dispozicion të studentëve. Pavarësisht kësaj, në vazhdueshmëri UMT ka mundësuar dhe bibliotekën Online (e-library) ku ka mundësuar pedagogëve dhe studentëve të UMT të kenë qasje në literaturë të përditësuar në kohë, të shkencave të ndërtimtarisë. Ndërkohë që pasurimi i bibliotekës UMT është ndër objektivat e përhershëm kryesor të UMT.

GVJ, mendon se bazuar në të dhënat; dokumentacionet e ofruara nga Institucioni, vizita në institucion, ky rekomandim është i përmbushur plotësisht, duke pas parasysh se programi i studimit MSc në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile është spektër i gjerë i fushave shkencore – sikur janë teoritë e strukturave, standardet për strukturat, projektimi dhe llogaritja e tyre dhe se kërkon azhurnim aktiv në pasurimin e fondeve të librave, punimeve shkencore, Handbook-s, Doracakëve, të cilat ju nevojiten studentëve dhe mësimit të tyre. Ndërsa IAL të e mendojë rritjen e kapaciteteve fizike të bibliotekës.

Analiza e përmbushjes së rekomandimit b)

- Së pari, nga viti 2016-2017 e vijim në programin e MSc Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile kanë aplikuar studentë që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në BSc në Inxhinieri Ndërtimi në UMT. Kuotat dhe kriteret e pranimit të miratuara në programin e MSc Inxhinieri ndërtimi mundësuan përzgjedhjen e studentëve me rezultate të larta.
- Politika e bursave të studimit për studentët ekselencë ishte një tjetër instrument për ofrimin e studentëve më cilësor në hyrje në programin MSc.
- Eksperienca e Alumni të suksesshëm që kanë përfunduar MSc në Inxhinieri Ndërtimi të punësuar në kompani apo që i janë njohur studimet dhe punësuar në profesionin jashtë vendit është një tjetër instrument, i cili ka realizuar efikas në përthithjen e studentëve që kanë përfunduar një cikël të parë me rezultate të mira.

Si më poshtë, tregohet qartë se nuk vërehet trend rritës i notës mesatare të studentëve në hyrje në programin e studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi, për dy profilet: Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti. Të dhënat për periudhën 4 vjecare, nga akreditimi i mëparshëm janë si më poshtë:

Profili Inxhinieri Strukturash

Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare në hyrje	Nota mesatare në dalje
2017-2018	22	3	6.79	6.51
2018 -2019	26	2	6.10	6.55
2019-2020	24	9	6.48	6.76
2020-2021	25	9	6.45	-

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

faqe 4

Profili Inxhinieri Infrastrukturë transporti

Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare në hyrje	Nota mesatare në dalje
2017-2018	13	2	6.48	6.3
2018 -2019	3	2	6.40	5.92
2019-2020	11	2	6.53	5.9
2020-2021	14	4	6.48	

GVJ mendon se bazuar në të dhënat, dokumentacionin e vënë në dispozicion, Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit për këtë çështje **nuk është përmbushur plotësisht.**



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profilet: Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti.

Bazuar në Urdhrin e ASCAL nr. 48, datë 24.06.2021, “Për përcaktimin e ekspertëve në akreditimin e programit të studimit”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

- Prof. Assoc. Dr. Florim Grajcevc
- Prof. Assoc. Dr. Gafur Muka

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në UMT, në datat 08-09 Korrik 2021, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Metropolitan Tirana. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 09.08.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 26/28 Prot., datë 30.08.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, “Universiteti “Metropolitan Tirana”” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

“Universiteti MT” përcjell përgjigjen për Draft-Raportin përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht me shkresë Nr. 259/1 Prot., datë 01.09.2021 “Kthim përgjigje “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, në kuadër të akreditimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profile: a) Inxhinieri Strukturash dhe b) Inxhinieri Infrastrukturë Transporti”. Në këtë dokument institucioni deklaron se nuk ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. Kështu Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Ndërtimi” me profile: a) Inxhinieri Strukturash dhe b) Inxhinieri Infrastrukturë Transporti

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE /MASTER I ARTEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Mbështetur në Statutin e IAL (RVB; EV.1, neni 4), misioni i Universitetit Metropolitan Tirana përfshin: <i>Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtaritë krijuese në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e Universitetit. Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike e kërkimit shkencorë. Formimin e studiuesve të rinj në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohorë teorik, metodik e praktik. Themelimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimit të lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kontribuimin në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</i></p> <p>Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni i ofruar mbështetës i IAL, u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Inxhinieri Strukturash"; "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti", të Universitetit Metropolitan Tirana, është hartuar në përputhje me Statusin e Universitetit, neni 4, misioni i institucionit. Është program studimi i cili përputhet edhe me kornizat ligjore të vendit dhe kompetencat që ofrohen.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.58</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit për Inxhinieri Ndërtimi në IAL ka filluar në vitin 2014/15. Për vitet e kaluara ky program tani më ka një konsolidim të mirë të punës akademike nëpërmjet stafit akademik dhe administratës dhe se interesat e zhvillimit të programit të studimit shkojnë në interes të vendit duke pas një produkt i cili konsiderohet i nevojshëm për vendin. Nevojat e vendit për kuadro të fushave të inxhinierisë së Ndërtimit konsiderohet shumë aktuale, efekti i paraqitjes së tërmetit në vitin 2019 në Durrës dëshmohej si fushë angazhim i IAL me studentët e këtyre programeve dhe me stafin akademik. Efekt i IAL lidhur me synimin e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare dëshmohej me marrëveshjet e bashkëpunimeve që ka institucionet e vendit dhe jashtë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.75</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	<p>IAL ofron një diversitet të programeve të studimeve të niveleve themelore BSc si dhe Master Shkencor, Master Profesional, programe 2 vjecare profesionale, të cilat mbulojnë në mënyrë joformale, duke filluar nga</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 7

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Statuti deri te organizimi i realizimit të tyre. Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profilet Inxhinier Strukturist dhe Inxhinier Infrastrukturë Transporti i takojnë Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës të Universitetit.</p> <p>Programi i ciklit të dytë të studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi arrin që nëpërmjet lëndëve të përgjithshme, profesionale, dhe atyre formuese, të krijoj një kuadër profesional me kompetenca më të thelluara në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p>Me kompetencat e fituara pas diplomimit studenti mund të vazhdoj në tregun e punës ose edhe në studimet e mëtejme më të thelluara. Duke qenë të qarta objektivat e përgjithshme të programit si dhe objektivat më të detajuara të lëndëve të programit të cilat kanë target tregun e punës në nivelin lokal dhe ndërkombëtar, ato sigurojnë edhe mundësin e studimeve dhe njohurive tjera shtesë.</p> <p>Në fushat e Veprimtarisë të përcaktuara edhe nga Statuti i Universitetit gjenden të përcaktuara edhe fushat e inxhinierisë. Ndërsa misioni i IAL është në shërbim të programeve të studimeve dhe mbi këtë bazë janë të funksionalizuara edhe kurrikulat e tyre duke zhvilluar aktivitete akademike dhe duke prodhuar produkte në përputhje të plotë me qëllimet e Institucionit. <i>RVB: Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.53</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Shkencat e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe sidomos profilet e Inxhinieri Strukturist dhe Infrastrukturë Transporti janë promotor i zhvillimit të vendit ndërsa konsiderohen kuadro potenciale për tregun e jashtëm dhe sidomos Evropian. Janë shumë veprime të IAL të cilat mund të klasifikohen si nxitëse për të ofruar tregut të punës kuadër të qëndrueshëm. Kjo u vërtetua nga grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitave në Institucion në takimet Studentët e nivelit Master si dhe Stafin akademik të Institucionit bartës të lëndëve të programeve të studimit</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Sipas kurrikulës të programit të studimit për profilet të cilat kërkohen të ri-akreditohen vlerësohet se përmbajtja e lëndëve brenda viteve të studimeve është e sistemuar në atë mënyrë që të krijohen vlera profesionale si dhe bazë të qëndrueshme të njohurive të thelluara shkencore për fushat e Inxhinierisë së ndërtimeve. Lëndët që i takojnë fushës së Teorisë së Strukturave sikur janë Dinamika e Strukturave, Inxhinieria sizmike garantojnë arritje të qëndrueshme të studentit për mundësi vazhdimi të mëtejme shkencore dhe padyshim edhe profesional duke gjet zbatim në projektim, ndërtim, Vlerësim etj. <i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.54</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.2

Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 8

<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>IAL ka të miratuar Strategjinë e zhvillimit të miratuar nga Senati Akademik në 2019. Në këtë dokument të aprovuar është e qartë se Universiteti së bashku me njësitë e veta akademike është i përcaktuar për programe akademike të avancuara dhe bashkëkohore në mënyrë që të joshë studentët duke pas prioritet ndërkombëtarizimin institucional.</p> <p>Programet e studimit për riakreditim për inxhinieri Ndërtimi mbështeten në konceptet themelore të strategjisë institucionale të zhvillimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.3</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Universiteti Metropolitan Tirana funksionon brenda ligjeve të vendit, ndërsa Statuti konsiderohet shtylla Juridike e Institucionit, e cila është e miratuar nga Senati Akademik i UMT-së së bashku me rregulloret funksionale të cilat përmbushin spektrin ligjor të IAL-së dhe janë brenda Statutit. Statuti përshkruan organizimin e studimeve brenda njësive të veta, kriteret për studime në nivelin e ciklit të parë, dytë dhe ciklit të tretë të studimeve.</p> <p>Ka një numër të konsiderueshëm të rregulloreve funksionale të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së të cilat rregullojnë programe të studimeve si dhe funksionimin e zyrave, njësive akademike dhe të tjera. Ekziston rregullorja e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, e cila përveç tjerash përcakton qartë çështjet lidhur me programet e studimeve, mënyrën e organizimit të aktiviteteve akademike për realizimin e qëllimeve, vizionit dhe misionit të përcaktuar të Institucionit.</p> <p>Programi i studimit Msc në “Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile është krijuar mbi këto baza ligjore të Institucionit dhe nga gjetjet e Grupit të vlerësimit të jashtëm, gjatë takimeve me grupe të caktuara sipas agjendës konstatohet se zbatimi i programit të studimit është në përputhje të plotë me dokumentet relevante të Institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.1 “Statuti i UMT”; Aneksi Nr.50.</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, përveç tjerash organizon programin e studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti. IAL ka të përcaktuara fushat e studimeve ndër të cilat janë studimet e Inxhinierisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se emërtimi i programit të studimit Msc në “Inxhinieri Ndërtimi” me profilet “Inxhinieri Strukturash” dhe “Inxhinieri Infrastrukturë Transporti” janë në përputhje të plotë me fushat si dhe me përmbajtjet e tyre me dokumentet dhe përcaktimet e Universitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profile përputhet plotësisht me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky program është ndërtuar duke respektuar dhe zbatuar ligjin për Arsimin e Lartë si dhe aktet e tjera për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar me Nivelin e 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>(https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010_korniza_shqiptare_e_kualifikimeve.pdf) dhe (http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 9

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i Studimit të ciklit të dytë, përkatësisht Master i Shkencave Inxhinieri Ndërtimi ka kurrikulën e sajë të ndarë sipas profileve të Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti.</p> <p>Kurrikulat e programit të studimit sipas profileve përbëhen nga lëndët të cilat janë të organizuara sipas parimeve “Bloom Pyramid”. Lëndët e ofruara, përkatësisht përmbajtjet e syllabueseve të tyre i ofrojnë studentit që të fitoj njohuri të avancuara shkencore përkatësisht formim profesional i cili gjen zbatim në tregun e punës si dhe mundësi e vazhdimit të studimeve në ciklin e tretë. Finalizimin e studimeve, programet e kurorëzojnë me punën praktike si dhe me punimin e diplomës.</p> <p>Objektivat e Programit të studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi me profilet; Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukture Transporti [Ev.53] janë të përcaktuara duke u mbështetur në objektivat e përgjithëshme të Institucionit dhe deklarojnë. Të përgadisë specialist të lartë, lider në fushën e tyre, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim.</p> <p>GVJ konsideron se këto objektiva në pjesën më të madhe në programin e studimit “Inxhinieri Ndërtimit” arrihen përmes organizimit të lëndëve në kurrikulën e programeve të studimeve për dy profilet duke përgaditur specialist të lartë të fushave të inxhinieri strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti.</p> <p>Programi i Studimit MSc “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profilet sikur janë pajisin studentët me njohuritë e thelluara shkencore të fushave profesionale për projektimin dhe llogarinë e objekteve, menaxhimin e ndërtimit të tyre si dhe vlerësime profesionale të aktiviteteve inxhinierike në fushat e Ndërtimit.</p> <p>Objektivat specifike të programit të studimeve MSc “Inxhinieri Ndërtimi” në profilin Inxhinieri Strukturash vlerësohen <i>nivelet e thelluara të njohurive shkencore për tipologji të ndryshme të strukturave nga betoni, celiku te objektet e ndryshme sikur janë objektet rezidenciale, objektet publike etj.</i></p> <p>Objektivat specifike të programit të studimeve MSc “Inxhinieri Ndërtimi” në profilin Inxhinieri Infrastrukturë Transporti vlerësohen <i>nivelet e thelluara të njohurive shkencore për Infrastrukturën e Transportit “rrjetet e transportit” objektet e artit si pjesë përbërëse e</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 10

	<p><i>tyre sikur Urat, tunelet etj.</i></p> <p>GVJ konsideron se IAL duhet të jetë fleksibile dhe të ofroj mundësi që programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi të pësojë ndryshime nga “riakreditimi në riakreditim” sipas kriterëve të përcaktuara <20% duke provuar përmbushjen e kërkesave nga tregu i punës.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ në IAL, në takimet me “Alumni” të diplomuarit dhe të punësuar në tregun e punës u identifikuan që për të ardhmen disa nga lëndët e kurrikulës të ndryshohen, sidomos fushat e menaxhimeve në inxhinierinë e ndërtimeve në mënyrë që të realizohet përshtatje me tregun e punës. Kjo mundësi mund të realizohet me rritjen e fondit të lëndëve zgjedhore brenda kurrikulës. <i>Aneksi Nr. 53</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>IAL ka dokument mbi studimin e tregut për programin e studimit Inxhinieri Ndërtimit. Treguesit e këtij përshkrimi të studimit janë të sintetizuar të prezantuar me analiza të numrit të studentëve vit pas viti në shkallë shteti dhe tregojnë qëndrueshmërinë e këtij programi të studimit.</p> <p>Universiteti shfaq dëshmi lidhur me arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimeve me institucione të ndryshme, GVJ i konsideron shumë të domosdoshme për zhvillimin institucional dhe veçanërisht edhe të programeve të studimeve duke zgjeruar kërkesat e ndryshme nga tregu i punës.</p> <p>Edhe gjatë takimeve në UMT, Alumni ishte mjaft aktive në pasurimin e shënimeve për studentët e diplomuar dhe informatat për punësimet e tyre. <i>Aneksi Nr.23; Aneksi Nr.74; Aneksi Nr.82.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat e Programit të Studimit të ciklit të dytë, përkatësisht Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile ka kurrikulën e sajë të ndarë sipas profileve të Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti nuk mund të vërehen në formën e definuar në dosjen e programit. Kur analizohet Kurrikula e programit të studimit sipas profileve atëherë objektivat qartësohen duke konsideruar se me këtë program studimi formohen inxhinierë të strukturave dhe inxhinierë të Infrastrukturës së transportit, të cilët do të ushtrojnë kompetenca të arritura nga studimet në rolet e Projektuesit – Dizajnerit, Ekspertit të vlerësimit të punëve inxhinierike, Menaxhimit të ndërtimit, pa e përjashtuar edhe mundësinë e shkollimit të avancuar shkencor të ciklit të tretë.</p> <p>Nga takimet e organizuara ne IAL, GVJ konsideron se Studentët e nivelit MSc para diplomimit dhe studentët e diplomuar shfaqin rezultatet e nxënies gjatë studimeve si dhe shkathtësitë e tyre në profesion duke prezantuar dhe zgjedhur edhe probleme të veçanta profesionale nga operativa – praktika. <i>RVB; Aneksi Nr.53.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të</p>	<p>Kurrikulat e programit të studimit sipas profileve përbëhen nga lëndët të cilat konsiderohen të domosdoshme për formimin profesional të inxhinierëve të ndërtimit. Përmbajtja e syllabuseve si dhe përmbajtja e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 11

studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<p>lëndëve janë të kompetencave të fushave të inxhinierisë të cilat krahasohen me programet e studimeve në vend, rajon si dhe në shumë institucione Evropiane.</p> <p>Nga takimet e organizuara në IAL, GVJ konsideron se Studentët e nivelit MSc zotëronin gjuhën Angleze. Kjo konsiderohet si element përmbajtësor i programit të studimit si dhe mundësia e punësimit të këtij kuadri edhe në nivel ndërkombëtar.</p>			
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	<p>Programi i studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi është i bazuar në sistemin e Bolonjës. Gjithashtu ky program është i bazuar në Ligjet vendore sikur është “NSDI-2015/2020”, (National Strategy for Development and Integration) dokument që përcakton politikatat kombëtare duke prekur çështjet e arsimimit, edukimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit të IAL dëshmojnë për synimin e Universitetit që programet e studimeve, stafi akademik, mobiliteti i studentëve të kontribuojnë në përvetësimin e praktikave më të mira Evropiane.</p>			
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	<p>Aftësimi profesional i studentëve të programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile është i bazuar në praktikatat profesionale të cilat studentët i realizojnë në formë të organizuar institucionale.</p> <p>Në takimet e GVJ me studentët vërtetua se praktikatat profesionale të studentëve të realizuara sipas objektivave të programit të studimit.</p>			
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	<p>Brenda lëndëve të programit të studimit, për profilet Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti, të përfaqësuara me syllabuset e tyre organizohen njësi mësimi të cilat mbulojnë kompetencat e Studentëve, rezultatet e arritshmërisë. Gjatë takimeve të GVJ me Mësimdhënësit në programin të studimit si dhe takimet me studentët u vërtetua se në shumë lëndë, mësimi organizohej në gjuhën angleze. Mirëpo jo i gjithë programi organizohet në gjuhë të huaj dhe ky mund të jetë shkak pse nuk ka ardhje të studentëve nga vendet e tjera.</p> <p>Lidhur me ndërkombëtarizimin e IAL, ekzistojnë dëshmi se angazhimi nuk mungon duke realizuar marrëveshje me shumë institucione ndërkombëtare si dhe bashkëpunimi në projekte të ndryshme institucionale.</p>			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	<p>IAL ka sistem të organizuar mirë të ruajtjes së shënimeve. Gjatë vizitës së GVJ konstatua se shënimet e studentëve në administratë ruhen dhe përpunohen me shumë kujdes. Faqja elektronike e UMT është kontribuuese e çështjes së azhurnimit dhe ruajtjes së informatave. Ndërsa dokumentacioni në gjuhën angleze nuk është i shprehur.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Me vendimin nr.357 datë 12.05.2010 është Licencuar “Universiteti Metropolitan Tirana” si shkollë private e arsimit të lartë me dy Fakultete, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të aplikuara si dhe Fakultetin e Ekonomisë. Me urdhër të MASR, Nr.195 datë 01.04.2019 bëhet Riorganizimi Institucional nga shkollë private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” në Universiteti Metropolitan Tirana, në përbërje të tri fakulteteve; Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Inxhinierisë dhe arkitekturës dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT me 8 departamente dhe një qendër e kërkimit shkencorë. Senati Akademik i UMT duke përmbushë kërkesat ligjore të vendit miraton vendimin nr.1170/1 datë 06.11.2020 për formimin e Njësisë së sigurimit të brendshme të Cilësisë (NJSBC) dhe e cila punon në bazë të rregullores së brendshme Institucionale .</p> <p>Nga dokumentacioni i më sipërm vërtetohet e UMT ka një organizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm Institucional duke filluar nga themelimi i tij. UMT ka të krijuara organet ekzekutive të sajë si dhe organet kolegjiale përmes së cilave sigurohet një hierarki e marrjes së vendimeve si dhe zbatimin e tyre.</p> <p>Në funksionimin e njësive akademike, Fakulteteve departamenteve ndihmojnë Statuti i UMT, si dhe rregulloret e brendshme të cilat sigurojnë një mbarëvajtje Institucionale pa zbrastësira.</p> <p>IAL ka të angazhuar personelin akademik efektiv dhe Personelin akademik me kontratë. Në programin Inxhinieri Ndërtimi PAE 9 ndërsa PAK 7. Pjesa e personelit administrativ e cila luan rol të rëndësishëm për funksionimin e Institucionit është e ndërtuar.</p> <p>Kapacitetet fizike të IAL për numrin e studentëve janë brenda standardeve. Asetet e infrastrukturës 4440 m² ndërsa numri i studentëve në FIA 390. UMT parashikon ndërtimin e kampusit të ri Universitar prej 1000 m².</p> <p>GVJ vlerëson se IAL ka kapacitete të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me profile Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.1; Aneksi Nr. 62; Aneksi Nr.66; Aneksi Nr.67; Aneksi Nr. 97; Aneksi Nr.107; Aneksi Nr. 108</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>Që nga fillimi brenda IAL funksionon Fakulteti i Inxhinierisë dhe për programin Msc në Inxhinieri Ndërtimi, kjo quhet standard i plotësuar përsa i përket përputhshmërisë së fushave institucionale dhe programeve konkurruese e dëshmuar edhe me Statutin e UMT.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi, me profile Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti, ka në përbërjen e tij fusha të shkencës së Fizikës të bashkë ndërlidhur me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 13

<p>udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>shkencat e matematikës që i përkasin Inxhinierisë si shkencë aplikative.</p> <p>Fushat e përgjithshme të studimit për MSc për dy profilet mund të konsiderohen se janë të përfshira përmes lëndëve me karakter të përgjithshëm shkencor sikur janë metodat numerike, teoria e probabilitetit, të cilat janë në përputhje edhe me programet tjera përkatësisht me Fakultetet tjera brenda UMT.</p> <p>Fushat specifike të programit të studimit për dy profilet janë me përmbajtje shumë profesionale të aseteve shkencore të cilat i japin karakterin e veçantë studentit, pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Programi i studimit për dy profilet përbëhen nga kredite (ECTS), të cilat përcaktojnë peshën e lëndëve. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave (katër semestra) nuk është e ekuilibruar që cdo semestër të ketë 30ECTS.</p> <p>Në semestrin e parë, shumica e krediteve nga peshat e lëndëve është 27 ECTS, në semestrin e dytë 33 ECTS, ndërsa në semestrin e tretë dhe të katërt të studimeve janë nga 30 ECTS. Punimi i diplomës së bashku me praktikën profesionale llogariten me peshë ECTS, dhe pas përfundimit të studimeve studenti merr diplomën me titull MSc, me 120 ECTS.</p> <p>GVJ konstaton se programi Msc në “Inxhinieri Ndërtimi”, për dy profilet Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti janë sipas kartës së Bolonjës. Ndërsa GVJ rekomandon që të ri-organizohet pesha e ECTS në të gjithë semestrat të jetë e barabartë 30ECTS. Programi i studimit në MSc Inxhinieri Ndërtimi mund të konsiderohet si mundësi e vazhimit të studimeve nga BSc “Inxhinieri Ndërtimi” i cili organizohet nga UMT. Ndërsa Institucioni siguron programin e studimit BSc, të profileve të njëjta me programin në shqyrtim.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit si pjesë përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës është përgjegjëse dhe organizon aktivitetet akademike për programin e studimit Msc në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profilet Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti.</p> <p>Sipas RVB, programet kanë përputhje me listën e profesioneve të Evropës. Studentët e diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi – profil Inxhinier Strukturash kodohen me kategorinë F sipas “Listo f NACE Codes” (me përfshirje F41 dhe F42).</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.54; Aneksi Nr.6</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin,</p>	<p>IAL ka të ndërtuar skemën organizative të sajë duke i përcaktuar detyrat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 14

<p>mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>dhe përgjegjësitë e njësisë akademike, zyra brenda institucionit si dhe pjesës së administratës së Universitetit. RVB e përpiluar dëshmon për marrëdhënie të mira ndërmjet administratës së Universitetit, zyra brenda sajë si dhe personelit akademik pa përjashtuar dhe Studentët të cilët janë pjesëmarrës aktiv.</p> <p>GVJ vlerëson se gjatë takimeve të organizuara në UMT është vërejtur një qëndrueshmëri e institucionit përsa i përket shpërndarjes së përgjegjësive dhe detyrave të secilit të punësuar në IAL.</p> <p><i>RVB; Shënimet në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Dëshmitë e ofruara të IAL lidhur me bashkëpunimet institucionale (si dhe nga vizita në institucion, nga GVJ është identifikuar se UMT ka marrëveshje me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ka mobilitetet të studentëve (nga UMT jashtë, ndërsa nuk ka studentë të ardhur) si dhe mobilitet të mësimdhënësve.</p> <p><i>Aneksi Nr.28; Aneksi Nr.72., Shënimet në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>IAL ofron dëshmi për lidhjen e 19 marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucionet arsimore ndërkombëtare. Gjithashtu lidhja e memorandumeve të bashkëpunimeve me institucione si dhe anëtarësime në rrjete është tregues i krijimit të mundësisë së pjesëmarrjes së stafit akademik në projektet kërkimore shkencore.</p> <p><i>Aneksi Nr.27; Aneksi Nr.22; Aneksi Nr.23; Aneksi Nr.75</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>IAL ka të miratuar rregulloren e praktikës mësimore nga Senati Akademik. Kjo rregullore përcakton organizimin e praktikës, detyrimet e Institucionit dhe praktikantit dhe metodat e vlerësimit të praktikantit. Rregullorja saktëson se praktika zhvillohet në Institucionet e caktuara nga Universiteti. Për programin e studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile studentët kanë të përcaktuar se në cilat institucione publike, private ose kompani mund të realizojnë praktikën. IAL ka të realizuar marrëveshje me institucione publike, private dhe kompani vendore për mundësi të realizimit të praktikës.</p> <p>Ndërsa brenda UMT është zyra e karrierës dhe Alumni, që mbështetin studentët për realizimin e praktikës.</p> <p>GVJ gjatë takimeve me studentët GVJ vërtetoi realizimin e praktikës nga studentët si dhe seriozitetin e studentëve lidhur me praktikën mësimore.</p> <p><i>Aneksi Nr.124</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>UMT dëshmon arritjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me Institute të tjera vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me realizimin e kërkimeve shkencore, si edhe projekte të përbashkëta në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Universiteti ka të rregulluar infrastrukturën ligjore për realizimin e mobilitetit për studentet, duke fuqizuar udhëzuesin për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët dhe udhëzuesin për plotësimin e planit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 15

	mobilitetit për stafin akademik, në kuadër të Erasmus+. Marrëveshjet e IAL gjithashtu konsiderohen kontribuese për kërkimet shkencore dhe mobilitet. <i>Aneksi Nr.26; Aneksi Nr.27; Aneksi Nr.23; Aneksi nr.75</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Në periudha vjetore IAL ndërton raporte periodike për analizën e punës dhe rezultatet e arritura. Marrëveshjet e arritura janë pjesë e këtyre raporteve. Ndërsa UMT ka të miratuar strategjinë e zhvillimit e cila ka synim ndërkombëtarizimin e Institucionit. <i>Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.73</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Në takimet e GVJ me mësimdhënësit, GVJ konstatoi se kishte praktika të mbështetjes institucionale për mësimdhënësit për çështjet e kërkimeve shkencore, përkatësisht publikimit të punimeve shkencore. IAL në strategjinë e sajë ka në prioritet kryesor kërkimet shkencore. GVJ nuk gjen se ka një mbështetje për stafin akademik dhe studentët për aktivitetet e tjera të kërkimeve shkencore. <i>RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.24</i>
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Zëvendës Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës i ka kompetencat e deleguara për çështjet e kërkimeve shkencore dhe vlerësimin e tyre. <i>GVJ konstaton se IAL duhet të inkurajojë dhe të mbështesë edhe më shumë personelin akademik në aspektin akademik dhe financiar për aktivitetet e kërkimeve shkencore.</i>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	IAL siguron mbështetje për fushën e kërkimeve shkencore të personelit akademik, përmes politikave të saja, duke realizuar marrëveshje bashkëpunimi. Brenda IAL është revista shkencore 'Metropolitan Tirana Journal of Engineering', me Bord shkencor, ku mund të botojnë punimet e tyre Stafit akademik dhe studentët. Kjo revistë është me ISSN. <i>RVB; Aneksi Nr.93</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Universiteti brenda strukturës funksionale të tij, ka Këshillin e Etikës, i cili punën e vet e ka të bazuar në rregulloren e Etikës. GVJ gjatë vizitës në IAL në takim me stafin akademik lidhur me çështjen e lirisë akademike konstatoi se FIA ka të përmbushur misionin, duke ruajtur integritetin e personelit gjatë vlerësimeve personale. Punën e pavarur të mësimdhënësve IAL e respekton në maksimum duke mos ndërhyrë në procese akademike.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 16

	<i>RVB; Aneksi Nr.14</i>			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	IAL mbështet veprimtarinë shkencore të stafit akademik. GVJ nuk gjeti të kishte praktika të inkurajimit të studentëve për kërkimet shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programi i studimit “Master Shkencor” organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit MSc në “Inxhinieri Ndërtimi”, për dy profilet, përbëhet nga lëndë që llogariten me peshë me kreditet ECTS. Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje të normale të parashikuar 2 (dy) vite akademike.</p> <p>Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave (katër semestra) nuk është e ekuilibruar për çdo semestër me 30 ECTS. Në semestrin e parë kurrikula i siguron studentit 27 ECTS, në semestrin e dytë 33 ECTS, në stemastrat tre dhe katër nga 30 ECTS. Punimi i diplomës së bashku me praktikën profesionale llogariten me peshë ECTS dhe pas përfundimit të studimeve studenti merr diplomën, me titull MSc në Inxhinieri ndërtimi me profil “Inxhinieri Strukturash”/ose diplomën MSc në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Inxhinieri Infrastrukturë Transporti”.</p> <p>Ngarkesa mësimore e studentit nuk tejkalon 25 orë në javë. (RVB)</p> <p>Organizimi i lëndëve në kurrikulë është realizuar me metodologjinë e përbërjes: 10% lëndë të përgjithshme, 52.5% lëndë profesionale, 12.5% lëndë integruese, 10% praktikë dhe 15% punimi i diplomës.</p> <p><i>GVJ rekomandon rritjen e lëndëve me zgjedhje të kategorisë lëndë profesionale.</i></p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.55; [Urdhër Nr. 366, Datë 23.12.2019 për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, MSC në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Inxhinieri Strukturash" të Universitetit "Metropolitan Tirana"] [Urdhër Nr. 367, Datë 23.12.2019 për regjistrimin e formës së diplomës</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 17

	<i>për programin e studimit të ciklit të dytë, MSc në "Inxhinieri Ndërtimi" me profil "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti" të Universitetit "Metropolitan Tirana"</i>
Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi, për dy profilet Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti përmbajnë studime të thelluara shkencore dhe këto njohuri studentëve mund të ju shërbejnë për mundësi të vazhdimit të studimeve të cikleve më të larta. Ky program studimi i jep një diversitet studentëve, pasi të i kenë përfunduar studimet. <i>RVB; Aneksi Nr.54 "Plani mësimor"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit "Master i shkencave" jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Për programin e studimit, MSc në Inxhinieri Ndërtimi, për dy profilet, studentët marrin njohuri të thelluara shkencore me të cilat ata mund të përdorin literaturë jashtëzakonisht të gjerë profesionale, kompetenca për vlerësime të projekteve profesionale si dhe zbatim të njohurive të përgjithshme akademike dhe zgjedhin probleme teknike duke evituar defektet dhe parregullsitë. <i>RVB; Aneksi Nr.54 "Plani mësimor"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Kompetencat e fituara nga programi i studimit janë me shtrirje dhe thellësi të cilat zbatohen në shumë situata të inxhinierisë së ndërtimit, duke filluar me udhëheqjen e ekzekutimit të objekteve, hartimin e projekteve profesionale për objektet -rrugët dhe gjatë gjithë situatave vepruese ndodh që të paraqitet nevoja e zgjedhjes së defekteve, parregullsive. Aftësitë e studentëve pas përfundimit të studimeve janë që të ballafaqohen edhe me gjendjen ekzistuese të objekteve, duke pasur kapacitete edhe për verifikimin e stabilitetit – qëndrueshmërisë së tyre. <i>Aneksi Nr.54 "Plani mësimor", Shënime në vizitë</i>
Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit përmban të gjitha elementet thelbësore që duhet t'i ketë një strukturist dhe një Inxhinier Infrastrukturë. Organizimi i tyre, kreditë, syllabuset janë të harmonizuara dhe brenda akteve ligjore. GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit – kurrikula, lëndët e organizuara, pesha e tyre është e projektuar si model i mirë. <i>Një rekomandim mund të identifikohet për kurrikulat që fondi i lëndëve zgjedhore nga fusha inxhinierike të rritet duke i mundësuar studentit një diversitet më i madh brenda studimeve, ndërsa të mendohet për një ri-organizim të ECTS brenda lëndëve ekzistuese. Do të ishte e nevojshme që studentët të kenë lëndë nga fusha e menaxhimit të ndërtimit.</i> <i>Aneksi Nr.54 "Plani mësimor", Shënime në vizitë</i>
Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Plani mësimor, i programit të studimit MSc në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile, i ka lëndët e grupuara sipas tipit të veprimtarisë: <ul style="list-style-type: none"> • lëndë bazë 10% • lëndë karakterizuese 52.5% • lëndë ndërdisiplinore/integruese 12.5% • lëndë plotësuese/praktike 10% • detyrime përmblylëse 15%

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 18

	<p>Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve, studenti fiton njohuritë për veprimtari profesionale dhe shkencore në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projektim - Zbatim - Verifikim – llogari - Analiza dhe studime krahasimi, etj. <p><i>RVB; Aneksi Nr.54 “Plani mësimor”</i></p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Diploma MSc ka peshën e sajë prej 18 ECTS dhe zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve. IAL lëshon edhe suplementin si shtojcë të diplomës, me përshkrim të detajuar të njohurive të fituara dhe klasifikimit të kompetencave. <i>RVB; Aneksi Nr.60</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit MSC në “Inxhinieri ndërtimi”, me profilet “Inxhinieri Strukturash dhe “Inxhinieri Infrastrukturë Transporti” është hapur për herë të parë në vitin akademik 2012-2013 në zbatim të UMASH Nr. 497, datë 18.10.2012 “Për lejen e veprimtarisë akademike të programeve të studimit në UMT”. Akreditimi i parë i programit është sipas UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016, bazuar në VKA Nr. 103, datë 3.11.2015, dhe VKA 103/1, datë 18.12.2015</p> <p>Universiteti “Metropolitan Tirana”, me njësitë kryesore të tij është akredituar si institucion i arsimit të lartë në Dhjetor 2017 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare. Pas riorganizimit të UMT si universitet dhe miratimit të statutit të ri, është akredituar, me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr.45, datë 05.07.2019. Afati i akreditimit institucional është deri në 14 Dhjetor 2022.</p>		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me</p>	<p>Njësia akademike, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka tri departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, 2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe 3. Departamenti i Shkencave të Natyrës. <p>Kualifikimi i Personelit Akademik në nivel Fakulteti (PAE dhe PAK) është, si më poshtë:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>Fakulteti i Inxhinierisë</td> <td>Viti akademik</td> </tr> </table>	Fakulteti i Inxhinierisë	Viti akademik
Fakulteti i Inxhinierisë	Viti akademik		

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 19

kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

së Ndërtimit dhe Arkitekturës	2020-2021	
	PAE	PAK
Prof Dr	3	2
Prof.Assoc	3	2
Dr	5	21
Msc (Dr në proces)	3	5
Msc	9	21
Ne total	23	51

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ne UMT është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitektures, i cili përfshin fusha kërkimi të ndërtimit dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, në 3 vitet e fundit, rezultojnë të dhënat e kualifikimit të stafit si më poshtë:

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	1	1	1	1	1	1
Prof.Assoc	1	2	2	2	-	1
Dr	2	10	1	10	2	6
Msc (Dr në proces)	2	-	2	-	2	-
Msc	2	18	1	18	2	8
Ne total	8	31	7	31	7	16

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit përmbush detyrimet ligjore duke realizuar punën brenda vetes duke shpërndarë peshën e punës të secili individ. Edhe raporti i vlerësimit të brendshëm për programin Inxhinieri Ndërtimi është i hartuar nga stafi i Departamentit, me kryetar të grupit – shefi i departamentit.

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit përmbush detyrimet ligjore duke organizuar dhe mbarë vajtur mësimin, vlerësimet e studentëve, vlerësimet e pedagogëve në mënyrë të vazhdueshme. Shqyrton programet e studimit brenda vetes, analizon kërkesa të ndryshme të stafit akademik, studion nevojat e departamentit. Departamenti i përgjigjet Dekanit të Fakultetit.

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi është shtytësi kryesor që çon më tej përmbushjen e Objektivave kryesore dhe të veçanta. Në çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lënde në grupe të ngushta në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohen dhe përsosën rezultatet e nxënies.

Bartësit e lëndëve janë me gradë shkencore Dr., për të cilën kujdeset departamenti. Struktura akademike është e rregulluar në nivel të Universitetit përmes kontratave dhe përcaktimit të detyrave kontraktuale ndërsa për përcjelljen e veprimeve akademike kujdes njësi bazë – Departamenti përkatësisht Fakulteti.

Raporti PAE/PAK=8/30 që do të thotë se rreth 26.67% janë Personel

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 20

	akademik efektiv ndërsa 73.33% janë personel akademik me kontratë. <i>RVB; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7</i>			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Departamenti i cili merret me organizimin dhe menaxhimin e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me 2 profile, është plotësisht i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë dhe detyrimet që kanë për realizimin e programit, duke respektuar kriteret ligjore për nivelin e studimeve Master Shkencorë dhe kjo është treguar në mënyrë kohezive në vitet paraprake të veprimtarisë lidhur me programin e studimit. Gjatë vizitës së GVJ në takimet me studentët konstatuam se praktika mësimore udhëhiqet nga personeli akademik i departamentit. Gjithashtu edhe ushtrimet laboratorike në ambientet e Universitetit udhëhiqen nga stafi akademik ndihmës.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit emëron koordinatorin e programit të studimit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Koordinatori i programit të studimit jep llogari Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit lidhur me shqetësimet e studentëve për realizimin e programit të studimit. <i>RVB</i>			
Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Në mbledhjet e Departamentit të Inxhinierisë së ndërtimit raporton periodikisht lidhur me problemet eventuale. <i>RVB; Aneksi Nr.116</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit Master Shkencor është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit është përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit Inxhinieri Ndërtimi, me profile: Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti. GVJ konstaton se materialet e ofruara, takimet me studentët dhe pedagogët dëshmojnë për angazhim maksimal të Departamentit për zhvillimin e programit të studimit duke i përcjellë me koshiençë suksesin e studentëve, duke organizuar kurse shtesë për studentët të cilët kishin nevojë. Për funksionimin e programit të studimit departamenti bazohet në respektimin e akteve ligjore dhe rregulloreve të Universitetit. Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 21

	<p>personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënie në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi</p> <p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë BSc në Inxhinieri Ndërtimi i cili jep formim më të gjerë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është zhvilluar në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Lëndët e programit të studimit përbëjnë kurrikulën, për të dy profilet “Inxhinieri Strukturash” dhe “Inxhinieri Infrastrukturë Transporti”. Programi i studimit përmban praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës ku është pjesa e hulumtimeve vetanake të Studentit.</p> <p>Programi i studimit në MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile, me nga 60 ECTS për çdo vit akademik, plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të krediteve brenda kornizës ligjore, e cila parashikon studime me kohë të plotë, dhe një minimum prej 120 kredite ECTS.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Kurrikula përbëhet nga të gjitha kategoritë e lëndëve të përgjithshme, profesionale, Integruese, plotësuese dhe përmbyllëse. Çdo lëndë ndahet në aktivitete formuese si: Leksione/ Seminare/ushtrime /laboratorë/ detyra kursi/praktika mësimore.</p> <p>Konkretisht për vlerësimin e arritjeve të studentëve rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 % Frekuentimi - 5% Aktivizimi - 10 % Test 1 + Test 2 - 10 % kontrolli i ndermjem - 10 % detyre kursi - 60 % kontrolli përfundimtar <p>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e veçanta të programit të studimit elementet e aktiviteteve akademike janë (RVB):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 430 orë mësimore - Ushtrime, seminare 290 orë mësimore - Laboratorë 40 orë mësimore - Detyra kursi 120 orë - Praktikë mësimore 240 orë <p>Punë në auditor e studentëve 1290 orë Punë individuale e studentëve 1710 orë</p> <p>Syllabuset përcaktojnë shpërndarjen e aktiviteteve mësimore, frekuentimin mënyrën e vlerësimit të studentit për lëndë, vlerësimet gjatë vijueshmërisë.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.54; Aneksi Nr.14</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ hasi në raste të transferime të studentëve nga institucionet tjera në UMT (në rastin e studentëve që ishin regjistruar në një program të dytë studimesh). Procesi i ekuivalentimit ishte realizuar nga vet IAL duke u mbështetur në programin e studimit të akredituar.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 22

dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi i studimit është lehtësisht i mundur të krahasohet me programe nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare për fushat e inxhinierisë së ndërtimit. Këtë e mundësojnë lëndët brenda kurrikulës, pesha e tyre si dhe përmbajtja.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.54; Aneksi Nr.14</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Forma standarde e syllabusit për lëndët e programit të studimit në Inxhinieri Ndërtimi është përmbajtësor dhe ka brenda vetes planin e punës përgjatë gjithë së zhvillimit, mësimi javor – përshkrimi, sasia e orëve në auditor, në ushtrime, laboratorë frekuenca etj.</p> <p>Syllabuset e lëndëve nuk bëhen publike në faqen elektronike të Fakultetit. Syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrit.</p> <p><i>GVJ rekomandon LAL që syllabuset të bëhen publike në faqen elektronike të Universitetit. Syllabuset duhet të freskohen në çdo kohë dhe sidomos në fazat e riakreditimeve.</i></p> <p>Për secilën lëndë mësimore të programit të studimit, syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrave përkatëse. Nga vizita në institucion u verifikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për programin e studimit dhe konstatohet se janë në përputhje me standardet.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.54 “Plan programet e lëndëve”</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit programi i studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile ‘Inxhinieri Strukturash’ dhe ‘Inxhinieri Infrastrukturë Transporti’ ka ndryshime minimale nga akreditimi i fundit.</p> <p><i>GVJ rekomandon institucionin që të planifikojë ndryshime për të ardhmen, duke pas parasysh kërkesat e tregut të punës si dhe analizat e ALUMNI.</i></p> <p><i>RVB</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës së mësimdhënies është në norma akademike dhe i shpërndarë përafërsisht në mënyrë të njëtrajtshme.</p> <p>GVJ vlerëson se ngarkesa e lëndëve në semestrin e parë dhe të dytë duke u mbështetur edhe në kreditet në semestrin e parë prej 27ECTS dhe në semestrin e dytë 33 ECTS nuk është e ekuilibruar. Studenti në semestrin e parë e ka ngarkesën më të vogël ndërsa në semestrin e dytë ngarkesa është më e madhe.</p> <p>Ngarkesa e studentëve në semestrat tre dhe katër është e ekuilibruar. Gjykuar sipas orarit të mësimi [E.89] për vitin akademik 2019/2020 mësimi Online</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 23

	<p>organizohej nga ora 17:00 deri 20:00 në cdo ditë pune. Ndërsa për arsye të Pandemisë COVID-19, IAL pjesën e mësimit në laboratorë i ka organizuar në fund të semestrit. <i>Evidenca 89</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Thellësia e studimeve, përkatësisht përmbajtja e kurrikulës me lëndët e sajë përmbajtësore krijon mundësi të nxënies së njohurive inxhinierike të thelluara dhe mundësitë e vazhimit të studimeve të ciklit të tretë dhe studimeve tjera të avancuara shkencore dhe profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.55</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>A) Në programin MSc Inxhinieri ndërtimi–profili <i>Inxhinieri Strukturash</i>, kurrikula përmban:</p> <p><u>Në semestrin e parë:</u> Teori e probabilitetit, Metoda numerike dhe MATLAB, Bazat e Teorisë së Elasticitetit me gjithsej 27 ECTS. Kjo përmbajtje i siguron studentit njohuri shkencore të përgjithësuar teorike të strukturave. Metodën numerike dhe MATLAB sipas takimit me stafin akademik jepet shpjegim se mendohet për metodat e elementeve të fundme për strukturat. GVJ rekomandon që kjo lëndë në të ardhmen të emërohet Metodën e Elementëve të Fundëm (FFE).</p> <p><u>Në semestrin e dytë:</u> Dinamika e Strukturave me Inxhinieri Sizmike, BetonArme – kurs i avancuar, Themele të thella, Struktura prej Çeliku, Struktura mbajtëse të dherave, me gjithsej 33 ECTS. Kjo përmbajtje e lëndëve është impulsive dhe duke pas 12 ECTS lëndët që i takojnë njohurive të fundamenteve dhe dherave, mirëpo organizimi i mundur i lëndëve me zgjedhje për këtë semestër mungon.</p> <p><i>Rekomandohet që (15 deri 20) % të lëndëve të jenë me zgjedhje dhe të rritet fondi i lëndëve me zgjedhje. Ndërsa ngarkesa në semestrin e parë është më e vogël në krahasim me semestrin e dytë. Është mirë që secili semestër të ketë ngarkesën e njëjtë.</i></p> <p><u>Në semestrin e tretë:</u> Projektimi i Urave, Vlerësimi sizmik dhe Përforcimi i Ndërtesave, Parime të projektimit të strukturave dhe me zgjedhje Projektimi i themeleve nën makineri me 30 ECTS. Kjo përmbajtje siguron strukturistin njohuri të thelluara të projektimit dhe llogarisë së strukturave. Ndërsa nuk i ofrohet studentit mundësi më e madhe të lëndëve me zgjedhje.</p> <p><u>Semestri i katërt:</u> është me punë praktike dhe diplome me 30 ECTS.</p> <p>B) Në programin MSc Inxhinieri ndërtimi–profili <i>Inxhinieri Infrastrukturë Transporti</i>, kurrikula përmban:</p> <p><u>Në semestrin e parë dhe të dytë</u> programi është idem si më lart.</p> <p><u>Në semestrin e tretë:</u> Projektimi i Urave, Mbishtresa – rrugë, hekurudha, Aeroporte, Projektimi i Tuneleve, dhe me zgjedhje Bazat e Inxhinierisë së trafikut rrugor me 30 ECTS. Kjo përmbajtje i siguron inxhinierit njohuri të thelluara të projektimit dhe llogarisë së objekteve të artit në linjat e transportit. Ndërsa nuk i ofrohet studentit mundësi më e madhe të lëndëve me zgjedhje.</p> <p><u>Semestri i katërt</u> është me punë praktike dhe diplome me 30 ECTS.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 24

	<p>Kjo shpërndarje e lëndëve për programin e studimit MSc, për dy profilet është funksionale. <i>Rekomandohet që IAL të realizojë ndryshime të vogla dhe sidomos ngarkesa në semestra të jetë e ekuilibruar në 30 ECTS.</i></p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.54</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Praktika profesionale ka peshë prej 12 ECTS që përbën 10% e peshës së studimit që për programin e studimit Master i Shkencave konsiderohet normë e pranuar. Me 12 ECTS duke llogaritur sipas normave Evropiane 25 orë pune e studentit për një ECTS praktikë profesionale studenti duhet të bëjë 300 orë pune, ose zbërthyer në ditë 37.5 ditë pune ose 2 muaj intensive (derisa semestri zgjatë 15 javë – ose tre muaj). GVJ konsideron se pesha në kredite e punës praktike është shumë e kënaqshme.</p> <p>Ndërsa brenda lëndëve organizohen edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional gjë që e rritë efektin e praktikës.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.54</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konsideron se ky program i studimit, për dy profilet është i projektuar sipas mundësisë së ofertës të të diplomuarave në tregun e punës. Pjesa praktike në kurrikulë është me hapësirë të mjaftueshme. Rritja e lëndëve me zgjedhje do të rrisë diversitetin e veprimtarive formuese të studentit. Kreditet ECTS janë të plotëpjesëtueshme me 3 dhe kjo gjë i ndihmon studentët për mobilitet dhe ekuivalentim të lëndëve duke pas mundësi të përputhjeve – përshtatjeve. Në bazë të prezantimeve në takimet me GVJ të punësuarit e këtyre profileve janë në shkallë të lartë.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në takimet e GVJ në IAL ndryshimet në syllabuse nga akreditimi i fundit janë të vogla dhe të pa përfillshme.</p> <p><i>GVJ rekomandon IAL që syllabuset të bëhen publike në faqen elektronike të Universitetit. Syllabuset duhet të freskohen në çdo kohë dhe sidomos në fazat e riakreditimeve.</i></p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.56</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtjet e programit të studimit sigurojnë mjaftueshëm përfitimin e aftësive profesionale dhe shkencore.</p> <p>Kompetenca të diversiteteve të veprimtarive rezultojnë jo shumë të gjera.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Kërkesat e tregut të punës duhet të jenë determinuese në përshtatjen e programit të studimit. IAL nuk ofroi ndonjë evidencë bindëse për vlerat kthyes nga tregu i punës, për ndonjë ndryshim ose plotësim të programit të studimit.</p> <p>Në takimet me studentët GVJ vlerëson njohuritë e fituara të të diplomuarve si dhe ofertën e tyre në tregun e punës. Nga të pranishmit në takim shumë prej tyre ishin të punësuar kryesisht në menaxhim të projekteve dhe pjesë e vogël në projektim dhe llogari strukturash.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa</p>	<p>GVJ rekomandon FIA, përkatësisht departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit që të intensifikojnë kontaktet me tregun e punës për fushat e inxhinierisë dhe të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 25

më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	marrin nektarin e tyre për përshtatjen e lëndëve sipas kërkesave të tyre.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Programi i studimit ka përmbajtje që siguron njohuri të mjaftueshme të formimit teorik dhe shkencor për studentin. Niveli i lëndëve teorike në përmbajtje të kurrikulës siguron që një student mund të merret me aktivitetet shkencore dhe të vazhdojë studimet në ciklin e tretë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5												
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”												
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me profile, të hartuara nga IAL realizohen nëpërmjet shërbimeve Administrative si dhe personelit Akademik të angazhuar.</p> <p>Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit.</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi është i përzgjedhur për të përmbushur objektivat e programit. Stafi akademik është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminarët e programit, që janë specifike për këtë program.</p> <p>Nga evidencat e ofruara nga IAL vërtetohet se bartësit e lëndëve janë me grada shkencore së paku Dr., [ka disa edhe me kualifikimin Msc (Dr ne proces), apo Msc - por këto asistojnë profesorët me tituj/grada].</p> <p>GVJ vlerëson gjetjet edhe gjatë takimeve me pedagogët se mbulueshmëria e lëndëve në programin e studimit është me mësimdhënës me grada shkencore Doktor i shkencave dhe Tituj akademikë prof.Dr dhe Prof.Assoc.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme (Tabela 12) në 3 vitet e fundit, rezulton me të dhënat si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="614 1848 1380 1915"> <thead> <tr> <th>Personeli i angazhuar në zhvillimin e</th> <th>Viti akademik 2020-2021</th> <th>Viti akademik 2019-2020</th> <th>Viti akademik 2018-2019</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				Personeli i angazhuar në zhvillimin e	Viti akademik 2020-2021	Viti akademik 2019-2020	Viti akademik 2018-2019				
Personeli i angazhuar në zhvillimin e	Viti akademik 2020-2021	Viti akademik 2019-2020	Viti akademik 2018-2019									

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 26

programit të studimit	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	1		1		1	
Prof.Assoc	2		2		2	
Dr/Doc	3	4	3	5	3	5
Msc (Dr në proces)	2	1	2	1	3	-
Msc	1	2	1	2	-	2
Ne total	9	7	9	8	9	7

Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës. Nga verifikimi i të dhënave statistikore, ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2018-2019	66 %
2019-2020	59 %
2020-2021	66 %

Për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. Rreth 66% është zhvilluar nga PAE dhe pjesa tjetër është përballuar nga stafi me kohë të pjesshme. *RVB, Tabela 12*

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Pjesa dërmuese e stafit akademik PAE dhe PAK të programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi janë të fushave inxhinierike me specialitete të inxhinierisë të niveleve të larta dhe që i shkon në favor programit të studimit, ndërsa lëndët individuale të tyre mbulohen me profesionalizëm të nivelit të lartë.

RVB

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

IAL ka të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri në fushat e Inxhinierisë së ndërtimit, i cili është përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale.

IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore për realizimin e praktikës profesionale.

RVB; Aneksi Nr.5

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit

GVJ gjatë vizitës në ambientet e Universitetit, përkatësisht laboratorëve të cilat shfrytëzohen nga studentët u udhëheqen nga stafi ndihmës i universitetit i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve.

Mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike në nivel të kënaqshëm.

RVB

Shkalla e përmbushjes së	PAE	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 27

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>UMT ka një listë subjektsh me të cilën dëshmohen qëllimet e marrëveshjeve të arritura ose mëtojnë të arrihen. Asnjë nga ato marrëveshje nuk ka të specifikuar ndonjë aktivitet lidhur me “Kthimin e informacionit nga tregu i punës” për eventualisht përmirësimin e programeve të studimit. GVJ rekomandon IAL që të fusë në funksion mundësinë e kthimit të informatës nga tregu i punës për përditësimin e programit të studimit.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.22</i></p>			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	<p>UMT ka një listë të gjatë të marrëveshjeve institucionale, të cilat i shfrytëzon më së miri për nevojat e saj institucionale dhe sidomos për mundësinë e zhvillimit të praktikës profesionale si dhe kërkimeve shkencore.</p> <p>GVJ në takimet me studentët, nga ata vërehej dëshirë e madhe për profesionin dhe studimet që kishin zgjedhur, gjithashtu edhe na takim me të diplomuarit dhe të punësuarit në tregun e punës, vërehej nevoja e “feedback-ut” nga tregu i punës, mirëpo edhe ndonjë dëshmi për shënime të tilla nuk është ofruar nga Institucioni.</p>			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	<p>UMT ka të ndërtuar dhe ka në funksion ALUMNI përmes së cilës zyre ruhen kontaktet me studentët e diplomuar. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, studentët e diplomuar japin kontribut duke shkëmbyer mendime në kuadër të përmirësimit të përbajtjes së lëndëve të programit të studimit. Alumni ka rrjetin e krijuar të studentëve të diplomuar.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.82</i></p>			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	<p>Nuk mungon bashkëpunimi i UMT me institucione kërkimore dhe shkencore.</p> <p>UMT organizon edhe trajnime shtese për stafin e vet si dhe për studentët.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.24</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
----------	------------------------	--	--	--

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 28


<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit përkatësisht kurrikula me lëndët e sajë dhe syllabuset e tyre qartësojnë prioritetet dhe objektivat e studimit. Ato janë me përmbajtje të thelluar shkencore, që si produkt i programit të studimit do të krijohen profesionist të cilëve ju jepet mundësia për vazhdim të studimeve të mëtejme në ciklin e tretë si dhe mundësi e zhvillimit të veprimtarive profesionale në tregun e punës.</p> <p>Objektivat e programit të studimit përputhen me objektivat e institucionit.</p> <p>Objektivat e Programit të studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi me profilet; Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastruktura Transporti [Ev.53] janë të përcaktuara duke u mbështetur në objektivat e përgjithëshme të Institucionit dhe deklarojnë: Të përgatisë specialistë të lartë, lider në fushën e tyre, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim.</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit menaxhon programin e studimit në Inxhinieri Ndërtimi me dy profilet, Inxhinieri Strukturash si dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti.</p> <p>Departamenti kujdeset për stafin akademik, për ngarkesën e tyre në mësimdhënie si dhe në punët administrative të IAL. Shkalla e lirisë akademike të stafit të UMT është e pa cenuar, ata mund të zhvillojnë kërkime shkencore në mënyrë të pa penguar dhe mund të kërkojnë edhe ndihmën institucionale që në fakt edhe ju ofrohet. <i>RVB</i></p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Ky program i studimit është shumë dinamik dhe me peshë shkencore dhe hulumtuese, prandaj studentët janë të motivuar nga vet natyra e problemeve që ju parashtrohen duke u sfiduar me detyra projektuese, analiza të rasteve studimore për raste shumë specifike sikur ishte rasti i tërmetit në 2019.</p> <p>IAL ka edhe buletinin e vet ku mund të publikohen punime të punuara nga studentët si dhe stafi akademik i UMT. <i>RVB</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profilet ka një standard i cili ka përputhshmëri me konceptet e formimit të Inxhinierëve të Ndërtimit. Ky ngjasim mund të gjendet në përmbajtje edhe me programet e studimeve në institucionet arsimore në vend, rajon dhe më gjerë.</p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik vërtetoi se sigurohet mbështetje institucionale për kërkimet shkencore, qofshin mbështetje akademike ashtu edhe financiare.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL të ndajë sasi buxhetore më të madhe për mbështetje të vazhdueshme të stafit akademik për kërkimet shkencore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet</p>	<p>Grupet lëndore janë me përmbajtje shkencore të thelluar. Me grupin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al




<p>grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>lëndëve të karakterit profesional mund të realizohen hulumtime shkencore.</p> <p>GVJ konstaton se ky program studimi është i zhvilluar në një dekadë nga e kaluara dhe laboratorët ekzistuese nuk janë të mundësive që t'ju ofrojnë stafit akademik dhe studentëve hulumtime shkencore të avancuara.</p> <p><i>UMT duhet të mendojë që për rritjen në cilësi dhe sasi të programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile duhet të krijohen kushtet – mjediset apo laboratorët më të avancuar, me pajisje më moderne, ose të bëhen edhe marrëveshje me institucione që i kanë këto kapacitete.</i></p> <p>UMT ka një reputacion shumë të mirë përse i përket marrëveshjeve institucionale. Janë shumë universitete me të cilat UMT ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.93; Aneksi Nr.75</i></p>			
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>UMT përkatësisht FIA, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit vërtetohet se janë mjaft aktive lidhur me realizimin e studimeve përkatësisht analizave sistematike brenda institucionit, për të fituar pasqyra sa më të qarta të arritshmërive të UMT.</p> <p>Përse i përket statistikave të kërkimeve shkencore, UMT dëshmon se viteve të fundit janë të numëruara punime shkencore prej rreth 50 të tilla. Në bazë të evidencave të ofruara nga UMT, aktivitetet institucionale janë në nivel të kënaqshëm. Në të gjitha aktivitetet– marrëveshjet e arritura janë të përfshirë personeli akademik.</p> <p><i>RVB; Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.93; Aneksi Nr.96; Aneksi Nr.99; Aneksi Nr.110</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>UMT ka të radhitura mjaft aktivitete lidhur me kërkimet shkencore përmes projekteve të ndryshme si dhe marrëveshjeve institucionale të realizuara. Është pjesë përbërëse e shumë projekteve ndërkombëtare.</p> <p>Ka të organizuara workshope, trajnime dhe aktivitete tjera me qëllim arritjen e objektivave të saja. GVJ nuk gjeti dëshmi për organizimin e ndonjë konference që lidhet me studimet e Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p><i>RVB</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1				
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	UMT organizon trajnime të stafit akademik. Gjithashtu GVJ vlerëson si praktikë të mirë edhe trajnimet paraprake të studentëve, pas gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19, ku UMT u organizua për mbajtjen e mësimi në mënyrë virtuale dhe shumë të suksesshme. Ky organizim konsiderohet si tregues i zhvillimit të metodave bashkëkohore në mësimdhënie.			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në strukturën (organigramën) e UMT janë zyra funksionale të cilat kanë detyrën e përcaktuar për përcjelljen e mbarëvajtjes së mësimi. NJSBC pjesë e UMT, është monitoruese dhe indikator për rritjen e cilësisë akademike. Brenda institucionit bëhen vlerësime të mësimdhënësve nga studentët dhe në varësi të rezultateve IAL reagon. Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit. <i>RVB; EV-4-Organigrama Struktura e Rektoratit.pdf</i>			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në takimet e GVJ me studentët dhe me mësimdhënësit vlerësuam se pjesa dërmuese e Studentëve bën vlerësimin e lëndës dhe mësimdhënësit sipas kriterëve të përcaktuara nga UMT. Këto vlerësime janë autonome dhe të paanshme. Ato kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarive akademike. <i>RVB; EV-9-Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>EV-10-Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik.pdf</i> <i>EV-11-Model i pyetësorit për studentet.pdf</i> <i>EV-12-Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimeve të studentëve për profesorët janë të organizuara në mënyrën institucionale duke i analizuar të njëjtat nga Dekani i Fakultetit deri te Rektori i UMT për të marrë masa konkrete. <i>RVB; EV-10-Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik.pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	FIA këto analiza nga vlerësimet e studentëve për pedagogët i shfrytëzon më së miri për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe normave akademike të pedagogëve. <i>RVB; EV-18-politika e cilesise UMT.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 31

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Procesi i zhvillimit të programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi për dy profilet nga UMT organizohet me aktivitete akademike nga të gjithë pjesëmarrësit, mësimdhënësit e rregullt, mësimdhënësit e angazhuar dhe ndihmës, administrata si dhe organet kolegjiale të UMT si dhe menaxhmenti.</p> <p>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e veçanta të programit të studimit elementet e aktiviteteve akademike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 430 orë mësimore - Ushtrime, seminare 290 orë mësimore - Laboratorë 40 orë mësimore - Detyra kursi 120 orë - Praktikë mësimore 240 orë (*) <p>(*) praktika mësimore konsiderohet e gjitha punë në auditor dhe duhet të jetë 12 kredite *25 kredite = 300 orë në auditor</p> <p><i>RVB; Evidenca 54 Plani mësimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me mësimdhënësit konstatohet se përdorimi i metodologjive alternative dhe bashkohore në mësimdhënie janë evidente dhe aplikohen rëndomtë nga mësimdhënësit. Rasti i mbajtjes së mësimin virtual përgjatë kohës së pandemisë ishte sfidues, ndërsa UMT planifikonte që të organizohen leksione shtesë për nevojat e studentëve.</p> <p>Në diskutimet me mësimdhënësit vërehej gatishmëri e madhe për të ju ofruar studentëve informatat e fundit bashkëkohore dhe të arriturat në profesionin e Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p><i>RVB; Evidenca 57 Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënies_Tabela nr. 4_.pdf; Shënimet në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UMT, njësitë akademike përbërëse të sajë përkrahin personelin akademik në mundësinë e diversitetit të mësimdhënies, krijimi i platformës elektronike për ligjëratat virtuale, takimet e rregullta me studentët analiza e nevojave të tyre.</p> <p>Puna e mësimdhënësve për punën me studentë në rastet e punimit të diplomave Master janë dëshmi për përsosmërinë e mësimdhënies dhe rritjes së efikasitetit të nxënies.</p> <p><i>RVB; Evidenca 64 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.pdf; Evidenca 65 Plan pune për punimin e diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilet.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Inxhinieri e Ndërtimi, me profilet Inxhinieri Strukturash dhe Inxhinieri Infrastrukturë Transporti, me lëndët mësimore të cilat janë pjesë e kurrikulës, stafi akademik i rregullt dhe ndihmës ju ofronin studentëve mundësi të mëdha për shpjegime për rastet studimore të cilat kishin ndodhe në shkallë reale (tërmeti në Shqipëri 2019). Në shkencat teknike të inxhinierisë së ndërtimit shpjegimi i efekteve të sjelljes reale të objekteve bëhen në modele eksperimentale, ndërsa stafi akademik këto raste i kishin shfrytëzuar mjaft mirë me punën me studentë.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 32

	<p><i>Evidenca 61 CV_Personeli Akademik_FIA.pdf</i> <i>EV-97-Oraret e Konsultimeve për programet studimit në FIA.pdf</i> <i>EV-70-Lista e dokumentave per dosjen e pedagogut.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Arritjet shkencore në profesionin e Inxhinierisë së ndërtimit janë me shpejtësi të mëdha në kohën reale. Këto informata mësimdhënësit i kishin të reflektuar në mënyrë periodike në mësimdhënien dhe metodat didaktike të tyre. GVJ konstaton se UMT ishte përkrahëse e përmirësimeve didaktike në mësimdhënie të zbatuar nga mësimdhënësit.</p> <p>Gjatë takimeve të GVJ në UMT dhe me takimet e ndara me mësimdhënësit dhe studentët u vërejt se niveli i ofrimit të informatave dhe nxitja e studentëve për të u kyçur në proces të nxënies ishte mbresëlënëse.</p> <p><i>Shënimet në vizitë</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Dinamika e programit të studimit, vizitat në terrene – objekte, duke parë praktikën e mirë dhe jo të mirë, defektet e objekteve të shkaktuara nga tërmeti, shkalla e dëmtueshmërisë, lidhja me pjesët teorike të mësimëve në auditor, ushtrimeve, laboratorëve, puna praktike e studentëve janë tërësi e këtij programi të studimit për të cilën studentit duhet të jetë pjesë aktive e aktiviteteve akademike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT disponon dy godina në Qytetin Studenti, Rruga “BUDI” dhe “SOTIR KOLEA”, të cilat krijojnë mundësinë e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>Godina 1, ka sipërfaqe totale 2347 m², në të cilën ndodhen 9 salla seminari me kapacitet 50 vende dhe 4 salla leksioni me kapacitet 100 vende. Aty ndodhen 2 laboratorë. Po kështu në këtë godinë ndodhet edhe biblioteka me një dhomë të vetme dhe me numër të vogël të ulseve në bibliotekë dhe e cila ka aktualisht 1250 tituj.</p> <p>Godina 2, e kampusit Universitar ka 2490 m² në të cilën ndodhen 8 salla seminari me kapacitet 40 vende dhe 4 salla leksioni me kapacitet 100 vende dhe 4 laboratorë.</p> <p>Godinat janë të pajisura me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditorë. Auditorët janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të procesit mësimor.</p> <p>Biblioteka e UMT për tre Fakultete dhe numrin e studentëve nuk i plotëson</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 33

	<p>kushtet minimale për nevojat e studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon që sa më shpejt të jetë e mundur të realizohet rritja e hapësirës së bibliotekës së universitetit.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.108, Asete infrastrukturore akademike _UMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambientet e dedikuara për procesin mësimor në Godinën 1 dhe Godinën 2, janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projektor dhe me internet (wireless).</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. Ky sistem është implemetuar që nga viti 2012, dhe është përditësuar në fillimin e vitit akademik 2020-2021 duke përdorë platformën edu4school. Sistemi mundëson menaxhimin e integruar të të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Sistemi është një platformë e integruar bazuar në një arkitekturë modulare duke krijuar mundësinë e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të UMT-së. Sistemi menaxhon në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, syllabusin e lëndës dhe materialet didaktike të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale të ndryshme), frekuentimin e studentit/lëndë, vlerësimet e studentit (vlerësimi i vazhduar dhe ai përfundimtar/lëndë) etj. Studenti në kohë reale ka qasje në ecurinë akademike të tij (lista e notave të lëndëve të shlyera, detyrimet akademike të pashlyera etj).</p> <p><i>Aneksi Nr.45, Ndërfaqja, Administratori, Pedagogu, Sekretaria, Studenti; Aneksi Nr.63, Procedura për zhvillimin e provimeve _FLA; Aneksi Nr.43, Sistemi informativ i menaxhimit të studenteve</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë qasje në literaturën që disponon Fakulteti dhe Universiteti në format fizik, pranë bibliotekës dhe atë online në edu4school.</p> <p>Megjithatë, një pjese e studenteve nuk kishin interes të përdornin bibliotekën, prandaj rekomandohet që krahas përdorimit të sistemit edu4school, biblioteka e institucionit të ndërmarë masa të tilla të cilat do të lehtësojnë e mundësojnë përdorimin e saj masivisht në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ofron rreth 1250 tituj, të ndare neper seksione, duke përcaktuar titujt e formimit të përgjithshëm, nga ato të profilit.</p> <p>Ne takimet me stafin akademik, rezultojnë se literatura e detyruar gjendet në bibliotekë.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ rekomandon shtimi i titujve të bibliotekës, si dhe zgjerimi i hapësirës së saj.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UMT-ja. Studentët kanë qasje të pakufizuar edhe në këto adresa, të cilat janë funksionale për bibliotekën</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 34

<p>akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>elektronike:</p> <p>http://www.thefreelibrary.com www.doaj.org http://www.gutenberg.org www.eBacheloro.com www.lawlink.coe.int ; www.cobis.al www.lawlink.nse.gov.au www.reatprint.com www.localjuris.com.fr www.freelebrary.com www.accessmylibrary.com</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/seminareve janë të pajisura me PC, projektorë. Biblioteka dhe laboratorët e informatikës janë të pajisura PC me programet e nevojshme. Për përgatitjen e diplomave studenti shfrytëzon si bazën e literaturës në hard copy ashtu edhe literaturë nga interneti apo biblioteka të tjera on-line në mjediset e bibliotekës.</p> <p>Nga vizita në IAL rezultojë se në funksion të programit të studimit për MSc në Inxhinieri Ndërtimi janë ngritur Laboratori i Informatikës, dhe Laboratori i materialit ndërtimor.</p> <p>Laboratori i materialeve ndërtimore kishte pajisje elementare për vlerësimin e cilësisë dhe rezistencës së Betonit, ishte funksional dhe i shërbenin procesit mësimor. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës</p> <p><i>Aneksi Nr.107, Ambientet për Infrastrukturën FIA-UMT] [EV-109-Relacion biblioteken (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike_UMT-FIA.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët janë të pajisur me adresë e-mail, e.mbiemer@umt.edu.al. Gjithashtu përdoren, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, Google Drive and sharing, Google Classroom etj.</p> <p>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimin edu4school, pedagogët përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>UMT, përdor platformën “GotoMeeting” në zhvillimin e procesit mësimor gjatë COVID 19.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentët dhe stafi përdorin sistemin edu4schools për shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës. Gjithashtu përdoren platforma GoToMeeting dhe email zyrtar me domain www.umt.edu.al.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Përmbyllja e studimeve realizohet ose me provim formimi ose me mbrojtje të punimit të diplomës për studentet me mesatare mbi 8. Në fillim të semestrit të gjashtë, studentet që kanë të drejtë të mbrojnë diplome me punim diplome përzgjedhin nga temat e ofruara ose propozojnë vetë një teme. Departamenti aprovon temën dhe i propozon udhëheqjen e një anëtarit të stafit akademik të</p>

	departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të udhëheqësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë në kontakte periodike (të paktën tre kontrole të ndërmjetme) gjatë gjithë semestrit, deri në përfundimin e punimit të diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UMT monitoron plotësimin e standardeve të mësimdhënies, duke ju nënshtruar periodikisht proceseve të akreditimit.</p> <p>(https://www.ascal.al/media/documents/ qaa%20eer/ University%20of%20metropolitan.pdf)</p> <p>Në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, UMT përcakton në Statut dhe rregullore, prioritetin për sigurimin e cilësisë, si dhe ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal). NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit ka përcaktuar koordinatore të programit të cilët, në bashkëpunim me NJSBC, e mbikëqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikëqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NJSBC-n. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p><i>Aneksi Nr.13, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit). (Aneksi Nr.03, Plani strategjik i zhvillimit të UMT. Aneksi Nr.07, VSA për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Aneksi Nr.10, Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë të programin të studimit. Institucioni ka angazhuar ekspertizë të jashtme në funksion të rritjes së cilësisë dhe sigurimit të saj.</p> <p>(https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara)</p> <p>Anëtarët e departamentit dhe fakultetit trajnohen vazhdimisht nga NJSBC dhe ekspertet e jashtëm të kontraktuar me këtë objekt. Eksperienca e fituar ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe fushën e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Strukturat nxisin studentët që të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 36

	<i>Aneksi Nr.50, rregulloren e FIA</i>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Institucioni inkurajon personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie duke u përshtatur me zhvillimet e programit të studimit, me synim që UMT të jetë një institucion novator në fushën e aplikimeve teknologjike. Për studentët e programit MSc në Inxhinierinë e Ndërtimit organizohen takime dhe leksione të hapura me profesionistë të fushes. Personeli akademik trajnohet për përdorimin e softeve apo programeve specifike për zhvillimin e procesit të mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>UMT motivon kualifikimin e mëtejshëm të personelit për kërkime dhe studime brenda dhe jashtë vendit. Kualifikimi jashtë vendit organizohet nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve, në kuadër të marrëveshjeve që ka lidhur UMT me institucione të arsimit të lartë, organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe të programeve ndërkombëtare si Erasmus⁺</p> <p>UMT ofron mbështetje financiare të gjeneruara nga vetë institucioni apo nga projekte ndërkombëtare dhe ka nxitur, mbështetur kualifikimin e stafit akademik të fokusuar në organizimin e konferencave/aktivitetëve shkencorë programet e shkëmbimit, promovimin e personelit akademik, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.24, Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese;</i></p>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>UMT mbështet personelin akademik dhe atë ndihmës akademik duke iu dhënë mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, i motivon në pjesëmarrje në veprimtari jashtë UMT, brenda ekspertizës së ndërtimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.22, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe anëtarësimet në rrjete) (Aneksi Nr.27, Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit/mobilitetit dhe trajnime ku stafi ka marrë pjesë</i></p>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>GVJ konstaton se në statut dhe strategjinë e zhvillimit, institucioni përcakton se personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik</p> <p>UMT ofron mbështetje institucionale duke vënë në dispozicion të personelit akademik infrastrukturë mbështetëse (laboratorë, ambiente, sisteme/ programe informatike, biblioteka etj.</p> <p>GVJ, gjatë takimeve me drejtuesit dhe stafin akademik, konstaton se Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës periodikisht në fund të vitit akademik analizon punën kërkimore dhe mësimore duke evidentuar arritjet dhe mangësitë, si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen</p> <p><i>Aneksi Nr.02, rregullore e UMT, Aneksi Nr.50 Rregullore e FIA). (Aneksi Nr.108, Asete infrastrukturorë akademike _UMT_Tab_Nr.8; Aneksi Nr.73, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2018-2019</i></p>

<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>NJSBC dhe Fakulteti vënë në fokusin e tyre metodat e mësimdhënies. Referuar takimeve me stafin dhe NJSBC evidentohet te jene organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, workshop-e etj., për metodat e reja, me pjesëmarrjen e të gjithë personelit akademik të UMT.</p> <p>Sfidat qe solli periudha e pandemisë ishin një shtyese qe ndihmoi institucionin ne implementimin e metodave novatore të mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>IAL organizon ligjërata të hapura me tema aktuale dhe atraktive të cilat mund te jenë edhe nga inxhinieria e ndërtimit.</p> <p>UMT ka të realizuara marrëveshje bashkëpunimi me institucione nga të cilat ftonin edhe mësimdhënës për tematika shumë specifike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen ne rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Gjithashtu, Senati Akademik ka miratuar një vendim te posaçëm për vlerësimin e vijuar. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.</p> <p>Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i qasen në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton te jete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi - 10 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) - 20 % testimet gjatë vitit - 60 % provimi përfundimtar. <p>GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është e qëndrueshme dhe kontinuale gjatë zhvillimit të mësimt.</p> <p><i>RVB; Evidenca 56 Plan programet e lëndëvesyllabuset_.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe</p>	<p>Në rregulloren e UMT-se dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lende me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 38

aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton te jete realizuar një proces i tille. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës. <i>EV-2-Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimeve</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Sipas Rregullores se provimeve, testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse për mbrojtjen e diplomës. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit. <i>Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimeve; Aneksi Nr.63, Udhëzimi mbi procedurat për zhvillimin e provimeve_FIA</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Programi i studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile përbëhet nga lëndë shkencore me përmbajtje voluminoze dhe zbërthimi i tyre bëhet përmes detyrave semestrale të studentëve. Këto punime semestrale duhen vlerësuar gjatë gjithë kohës së semestrit (ngaqë lëndët janë një semestrale). Në takimit me studentët, GVJ konstatoi se vlerësimi i studentëve është i vazhdueshëm gjatë procesit të zhvillimit të lëndës dhe vlerësimet e arritura merren parasysh në vlerësimin përfundimtarë. <i>Shënime në vizitë</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Kujdesi për vlerësimet e studentëve nga mësimdhënësit, organizimi i testeve, mënyra e mbajtjes së tyre vlerësohet se është brenda standardeve akademike dhe nuk mund të ketë abuzim. UMT ka një sistem elektronik të ruajtjes së shënimeve të studentëve i cili është i qëndrueshëm dhe shumë funksional, ndërsa ju shërben studentëve dhe mësimdhënësve www.edu-4schools
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i	Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 39

<p>vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithshme e UMT-së, Rregullorja e provimeve dhe Udhëzimi i Dekanit të FIA.</p> <p><i>Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimeve; Aneksi Nr.63, Udhëzimi mbi procedurat për zhvillimin e provimeve_FIA</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Kontrolli i testeve dhe provimeve zhvillohet në mënyrë konfidenciale sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e brendshme dhe të provimeve. Vlerësimi i njohurive në mes të vitit dhe në fund të vitit bëhet i koduar në mënyrë anonime. Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Tezat sekretohen nga sekretaria me barkod dhe kontrollohen nga pedagogu në mënyrë anonime. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e provimeve sallat e leksioneve, që janë të pajisura me kamera, për monitorimin e procesit të provimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.120 rregullorja e provimeve; Aneksi Nr.63, Udhëzim i FIA mbi Procedurat për zhvillimin e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të UMT-së. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</p> <p><i>Aneksi Nr.63, Udhëzim i FIA mbi Procedurat për zhvillimin e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës së pedagogut dhe Rregullores së Etikës.</p> <p><i>Aneksi Nr.120 rregullore në provimit; Aneksi 14.Rregullorja e Etikës -UMT; Aneksi Nr.64, Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi edu4school, ose edhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 40

<p>rregulloret përkatëse.</p>	<p>me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda tre ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.</p> <p>Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuize, prezantime ne grup ose individuale, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.120, Rregullore e provimit</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentet, ata njohin te drejtën e tyre për ankimim. Mbas shpalljes se rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.</p> <p>Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë.</p> <p><i>Rregullore e UMT; Rregullore e provimeve</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Kërkesa për ankimim note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UMT.</p> <p><i>Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimit; Aneksi Nr.63, Udhëzimi mbi procedurat për zhvillimin e provimeve_FIA</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike shkencore ne fushën e ndërtimit, praktiken profesionale dhe diplomën. Kjo kurrikul parapërgatit studentet për mundësinë e vazhimit te studimeve te ciklit te trete.</p> <p>Syllabuset e lëndës paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse.</p> <p>Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafi akademik përfshin studentet në veprimtari jashtëkurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e ndërtimit.</p> <p>Studentet përfshihen edhe në veprimtarinë kërkimore të stafit. Ato</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 41

	<p>inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi.</p> <p>UMT ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat mësimore dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, FIA punon për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.</p> <p>Projektet kërkimore kanë në fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Gjatë vitit 2019 -2020, UMT ka aplikuar ne 17 projekte të ndryshme dhe është në procesin e implementimit të 7 projekteve të cilat i ka fituar. Në kuadër të projekteve kërkimore dhe mobilitetit JoinEU-SEE III, ERAWEB I, CEEPUS, në vitin akademik 2017-2020 nga Fakulteti, 3 studentë kanë realizuar një tremujor studime në universitetet partnere në kushtet e mobilitetit.</p> <p><i>Aneksi Nr.56, syllabuset; Aneksi Nr.99, Lista aktiviteteve (leksione te hapura); Aneksi Nr.27, Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit/mobilitetit; Aneksi Nr.23, Lista e marrëveshjeve ne kuadër te programeve te FIA; Aneksi Nr.24, Lista e projekteve aplikuar nga UMT dhe projektet fituese; Aneksi Nr.28, Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve dhe stafit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, programi i studimit MSc Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile përmban lëndët Metoda numerike dhe MATLAB, ndërsa mendohet se njohuritë themelore për programe profesionale si AutoCAD, janë të arritura nga studimet e ciklit të parë, ndërsa studentët i përdorin softwerët profesional për nevojat e projekteve të tyre sikur; SAP, ANSYS, ETABS, MS PROJECT, etj.,</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javët e fundit, pedagoget e lëndës informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të përmbajë provimi final dhe gjithashtu si dhe për peshën që do të ketë në notën finale të lëndës në provimin final.</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur ne syllabus. Këto elemente qe detajohen ne çdo lende janë pjese e objektivave te përgjithshme te programit.</p> <p><i>Aneks.56: Syllabuset e lendeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javët e fundit, pedagoget e lendes informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca dhe simpoziume workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL të tjera iu është krijuar mundësia e mbështetjes konkrete për kërkimin shkencor.</p> <p>UMT organizon ligjërata të hapura me tema jashtë kurrikulës mësimore. https://umt.edu.al/en/evente-en/articles/Leksione-te-hapura-nga-Departamenti-i-Inxhinierise</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Studentët e programit MSc në Inxhinieri Ndërtimi kanë në dispozicion laboratorët kompjuterikë, laboratorin e materialeve të ndërtimit, si dhe praktikat profesionale. Përsa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e vet me strukturat e tjera, duke i asistuar në zhvillimin e praktikave profesionale, gjë që përbën edhe një objeksion gjatë zhvillimit të saj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës.</p> <p>Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përbën një ndër kompetencat e programit MSc në Inxhinieri Ndërtimi.</p> <p><i>Aneksi Nr.54, Kurrikula e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studenteve.</p>	<p>GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor në UMT aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në UMT është krijuar dhe funksionon qendra kërkimore.</p> <p>https://umt.edu.al/qendra-metroresearch</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>IAL është promovuese e vlerave akademike dhe kërkimore që ju referohet programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profilet. Vetë programet MSc në Inxhinieri Ndërtimi, përmbajnë thellësi të shkencave nga të cilat studentët gjejnë inspirimin për hulumtimin e shkaqeve dhe fenomeneve të jashtme si mbingarkesa nëpër "Objektet e tyre", duke provuar identifikimin e parametrave racional të sjelljes së strukturës. Vizitat studimore të studentëve nëpër objektet – kantieret e ndërtimit, studiot e projektimit etj. ju japin përkufizim profesional të tyre.</p> <p>UMT ofron një gamë marrëveshjesh institucionale Fakulteteve për mundësi të shfrytëzimit të tyre për interesa të përgjithshme.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Puna me projektet kërkimore në UMT, ka si fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja kërkimore.</p> <p>Në UMT janë krijuar dhe funksionojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Qendra Metroresearch</i> si pjesë integrale e aktivitetit shkencor dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 43



	<p>akademik të UMT, që prezanton standarde të aplikueshme kryesisht në fushën e edukimit, menaxhimit, lidhshmërisë, ndërtimit, TI, zhvillimit të qëndrueshëm etj., dhe ofron mentorim, menaxhim apo konsulta për partnerët strategjikë në zhvillimin e projekteve kërkimore. https://umt.edu.al/qendra-metroresearch</p> <p>- Metropolitan Incubator (pjesë e Qendrës Metroresearch dhe UMT). Këtu, studentët dhe të rinjtë kanë mundësinë të krijojnë një Start-Up dhe t'i finalizojnë idetë me një produkt përfundimtar. https://umt.edu.al/metropolitan-incubator</p> <p>UMT organizon <i>Konkursin Kombëtar "Start Up City"</i>, (në nivel universitar Shqipëri dhe Kosovë). Sivjet u zhvillua edicioni i trete. Në "Start Up City" fituesit përfitojnë 2500 euro. Start Up City" ndihmon studentët dhe të rinjtë të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit, duke i prezantuar përballë një jurie. https://umt.edu.al/evente-sq/articles/Seksion-informues-mbi-Start-Up-City-3</p> <p><i>Aneksi Nr.22; Aneksi Nr.23; Aneksi Nr.75</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>UMT parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullative. Rregullorja e Fakultetit shpreh procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në FIA. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka të miratuar rregulloren specifike të diplomimit ku janë të përcaktuara procedurat, formatet dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Rregullorja e FIA shpjegon të gjithë procesin e diplomimit të studentëve të cilët janë pjesë e IAL. FIA ka rregulloren e veçantë me të cilën përcaktohen procedurat e diplomimit, format dhe modalitetet e mbrojtjes etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.58; Aneksi Nr.64</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sipas ligjeve të arsimit të lartë në Shtet, programi i studimit MSc duhet të përmbajë temë diplome. IAL në programin e studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profilet e përmbush këto kërkesë ligjore duke organizuar diplomat MSc. Rregulloret e brendshme institucionale zbatohen në mënyrë korrekte dhe i ndihmojnë studentët si dhe pedagogët në procedura.</p> <p>Sipas rregullores së brendshme të FIA komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar (banka e tematikave), si dhe për projektin e diplomimit dhe i shpërndajnë ato tek studentët në fillim</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 44

	<p>të semestrit.</p> <p>Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore. Udhëheqësi i punimit përgatit programin e punës së studentit, duke përcaktuar afatet për realizim.</p> <p>Departamenti miraton tezat e diplomës. Studentët informohen paraprakisht lidhur me procedurat për diplomën përmes mësimdhënësve të njësive akademike – departamentit.</p> <p><i>Aneksi Nr.58; Evidenca 64 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ konstaton se, rregullorja e IAL për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës për programin e studimit MSc, përcakton qartë dhe radhit veprimet që duhet të realizojë studenti hap mbas hapi , si dhe veprimet e institucionit.</p> <p>Nga institucioni ngrihet një komision për mbrojtje të temës së diplomës.</p> <p><i>Aneksi Nr.59; Aneksi Nr.60; Evidenca 64 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Secili nga pedagogët e programit të studimit – bartësit e lëndëve përgatit një listë të temave të diplomave. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit i miraton temat e diplomave si dhe bartësit e tyre. Nuk përjashtohet mundësia edhe e propozimit të temës së diplomës nga vetë studenti.</p> <p>Mësimdhënësit ndihmojnë studentët duke i orientuar në fushat e studimeve dhe duke ju siguruar informata paraprake dhe literature të nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. Studenti konsultohet dhe ndihmohet nga udhëheqësi si dhe një konsulent.</p> <p><i>Evidenca 64 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Laboratorët brenda UMT janë në dispozicion për shfrytëzimin e tyre nga studentët. Në rastin kur natyra e temave të diplomave kanë nevojë për ekzaminime, institucioni i ndihmon studentët edhe jashtë UMT, për realizimin e tyre. Të gjitha mjediset e UMT janë në shërbim të studentëve së bashku me administratën, personelin akademik dhe ndihmës.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, ndihmon në zgjedhjen e probleme si dhe asiston në analizë sintetike.</p> <p>Punimi përmban rezultatet dalëse, analiza të vlerave si dhe përfundime për të cilat udhëheqësi i punimit ka përgjegjësi dhe duhet të garantoj për vlera të pa cenueshme të punimeve.</p> <p>Punimi i diplomës vlerësohet me notë nga komisioni i mbrojtjes së diplomave. Secili anëtarë vlerëson punimin në mënyrë të pa varur. Vlerësimi komunikohet në prani të komisionit studentit nga kryetari i komisionit.</p> <p><i>Evidenca 64 Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të</p>	<p>Pas përfundimit të diplomimit, studenti pajiset me diplomë dhe me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 45

studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	suplementin e diplomës i cili është model i miratuar nga Komisioni Evropian, këshilli i Europës dhe UNESCO/CEPES i punuar në dy gjuhë, shqip dhe Anglisht. <i>Aneksi Nr.59; Aneksi Nr.60</i>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Ky material është i përgatitur në dy gjuhë, fakt që ndihmon studentin kur shkon jashtë shtetit për studime ose punësim.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen pas diplomimit, në arkivin e institucionit dhe më pas, sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme. <i>Aneksi Nr.87, Shembull_Dosje studenti të regjistruar</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë aktivitetit akreditues në UMT, GVJ u interesua posaçërisht për të dhënat lidhur me personelin akademik PAE, PAK dhe me atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ. Konsideruar si një faktor shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e gjithë aktivitetit të një institucioni, por veçanërisht procesit mësimor dhe atij kërkimor shkencor, GVJ konsultoi dokumentin e sjellë nga Institucioni lidhur me plotësimin e këtij kriteri si dhe protokollin e mbajtur gjatë vizitës në UMT dhe konkludon në plotësimin e këtij kriteri nga ana e institucionit. Të dhënat për personelin e angazhuar në PS Msc në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profile: “Inxhinieri Strukturash” dhe “Inxhinieri Infrastrukturë Rrugore” ishin të plota dhe të aksesueshme. Të formuluarat dhe të miratuara mbështetur në dispozitat

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 46

	<p>ligjore e aktet nënligjore e, për pasojë, edhe në rregullimet ligjore të UTM (Statut, Rregullore, plan strategjik), ato garantojnë qoftë arritjen e objektivave në procesin mësimor e atë kërkimore shkencor, qoftë edhe për të ndjekur një dinamikë në progresimin cilësor të tyre.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.29; Aneksi Nr.66; Aneksi Nr.67; Aneksi Nr.68, Aneksi Nr.69, Aneksi Nr.70, Aneksi Nr.71, Aneksi Nr.72, RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri Institucioni na vuri në dispozicion dokumentacionin përkatës (RVB), si dhe na mundësoi takimin me stafin akademik të PS. Nga konsultimi me dokumentacionin GVJ konstaton që rekrutimi i PA bëhet në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatorë të institucionit. Gjatë vizitës në UMT, në takimin me personelin akademik, GVJ u njoh me realizime konkrete të procedurave të rekrutimit dhe i gjeti ato në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatorë të institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.29; RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në RVB thuhet që: <i>për përzgjedhjen e PA, institucioni ngre komisionet ad-hoc të vlerësimit me 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të Departamentit, një i Dekanatit dhe një i rektoratit.</i></p> <p>GVJ kërkoi njohjen me punën e këtij komisioni. Në përgjigje të kësaj kërkesë shpjegimet na u dhanë nga vetë PA kur treguan procedurat konkrete të rekrutimit të tyre, ndërsa dokumentacionin e plotë e gjetëm tek Zyra e Burimeve Njerëzore. Bazuar në këto gjetje GVJ gjykon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave UMT; Shënimet e takimeve ne UMT</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Nga RVB, GVJ mësoi që nevojat për rekrutim personeli i paraqet Departamenti që mbulon PS. Nevojat mbështeten në shpërndarjen sa më eficiente të ngarkesës mësimore të lëndëve të kurrikulës konkrete. Pra personeli i rekrutuar lidhet konkretisht me përballimin sa më të plotë të ngarkesës së lëndëve për të cilat ka edhe përvojën edhe njohuritë e duhura që garantojnë zhvillimin me cilësi të procesit mësimor dhe angazhim në punën kërkimore shkencore. Gjatë takimeve në institucion GVJ mësoi që personat e rekrutuar kanë përballuar me cilësi ngarkesën mësimore dhe kanë angazhim domethënës në kërkimin shkencor. Në takimin me studentët, ata shprehën vlerësime për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët e angazhuar ne PS “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi”, në dy profilet.</p> <p><i>Aneksi Nr.29; RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 47

programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ vizitoi ambientet bazë si të strukturës administrative ashtu edhe të asaj mësimore e kërkimore-shkencore. Gjatë këtyre vizitave, bazuar edhe në të dhënat e RVB, GVJ gjeti që të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të aktivitetit universitar ishin me kushte të mira. Auditorët, klasat për seminarët e ushtrimet si dhe laboratorët kishin pajisjet e nevojshme për një aktivitet normal mësimor dhe një kërkim optimal shkencor. Hapësirat ishin të bollshme, me ndriçim të mirë me kondicionerë. Të pyetur për shfrytëzimin e kapaciteteve ambientale e teknologjike përgjigja ishte se kapacitetet e projektuara ishin afërsisht sa dyfishi i atyre të shfrytëzuara, çfarë flet për përballim e kërkesave për PS edhe nëse ato dyfishohen. Po ashtu GVJ mësoi që UMT kishte një projekt konkret për ndërtimin e një korpusi të ri universitar me sipërfaqe rreth 10.000 m². Në përfundim, pasi konsultoi të gjitha dokumentacionet e vëna në dispozicion GVJ vlerëson plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Aneksi Nr.91; Aneksi Nr.108; RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentet që na vuri në dispozicion UMT (DVV) si dhe protokollit i vizitave në institucion, GVJ u informua për metodat dhe procedurat që ndiqen në këtë institucion me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Ai konstatoi që mënyrat e ndjekura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Angazhimi i lektorëve të huaj dhe personaliteteve nga fushat inxhinierike - Trajnimet për njohjen e përvetësimin e metodave inovative në procese specifike - Programet e mobilitetit në kuadër të programeve ndërkombëtare - Pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta me institucione të huaja dhe vendëse - Trajnimet me AKKSH për mundësitë e aplikimit dhe informacion mbi aplikimet. <p>Për t'u njohur me efincenë e këtyre metodave GVJ drejtoi pyetje gjatë takimit me stafin akademik. Tek pyetja: sa ju mbështet institucioni për kërkimin shkencor, një pedagog pohoi që universiteti ofron mobilitet me partnerët, ofron laboratorët e tij si dhe lidhje marrëveshesh. Ndërsa një tjetër anëtar i stafit me rreth 5 vite punë deklaroi që për pjesëmarrjen në një konferencë jashtë të gjitha shpenzimet m'i pagoi universiteti. Nga një analizë tërësore GVJ vlerëson që kriteri plotësohet, <i>por ai do të sugjeronte një përfshirje edhe më të madhe në projekte për realizim doktoratash.</i></p> <p><i>Tabela 6, cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat</p>	<p>Referuar dokumenteve të tillë si RVB, Tab 17, EV 3, EV 18, EV 102 si dhe vizitave në ambientet e universitetit, të cilat ishin në dispozicion të PS Msc</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 48

inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>“Inxhinieri Ndërtimi”, konstatohet që disponohen teknologji të reja të cilat ishin në përdorim. Psh u konstatua që teknologjia e mësimit online në sistemin e menaxhimit GoToMeeting ishte adaptuar në kushte optimale, duke u krijuar lehtësi si pedagogëve ashtu edhe studentëve në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Po kështu me teknologji të re ishin pajisur laboratorët, si ai i materialeve të ndërtimit, gjeoteknikës, laboratorit multifunksional etj, të cilët ishin funksionues edhe në sajë të kualifikimit profesional të PA. Në përfundim GVJ konfirmon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.18; Aneksi Nr.48; Aneksi Nr.102; Tabela 17, platforma Online; RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>Në RVB thuhet: <i>Angazhimi i Burimeve njerëzore për realizimin e PS në UMT mbështetet në legjislacionin për arsimin e lartë.</i> GVJ e gjen të vërtetë këtë pohim dhe, në takimin me personelin akademik, u informua që si ngarkesa e tyre në auditor ashtu edhe ajo jashtë auditorit janë optimale dhe u lejon atyre përmbushjen e të gjitha objektivave të PS “Msc në Inxhinieri ndërtimi”, me dy profile.</p> <p><i>Aneksi Nr.57; Tabela 57, ngarkesa e personelit; RVB; Shënimet e vizitave UMT.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UMT vë në dispozicion të realizimit të aktivitetit mësimor, kërkimit shkencor dhe administrimi të tij dy godina me sipërfaqe respektive 2347 m² dhe 2490 m². Sipërfaqja e vënë në dispozicion të FIA (njësia kryesore për PS Msc në Inxhinieri Ndërtimi) është 2754 m². Ambientet e vëna në dispozicion shfrytëzohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Auditorë mësimi - Studio - Ambiente për aktivitete promovuese - Laboratorë - Ambiente për kërkimin shkencor; - Ambiente shërbimi si (bibliotekë, salla interneti, fotokopjime, salla studimi, zyra për informim të studentëve si dhe ambiente ndihmëse të tilla si korridorët, ballkonet banjot) <p>Pyetjes për shfrytëzimin e kapaciteteve që ofron institucioni, grupi i NjSBC iu përgjigj që për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile numri i studentëve që mund të pranohen për çdo profil është deri në 30 kur, për katër vitet e fundit, numri në të dy profilet e këtij PS nuk ka qenë më i madh se 34.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 49

	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, i vizitoi të gjitha këto ambiente dhe konstaton që ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke marrë në konsideratë numrin e studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit e moduleve përkatëse.</p> <p><i>Aneksi Nr.91; Aneksi Nr.108; Aneksi Nr.62: RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ vizitoi mjediset mësimore ku zhvillohej procesi për realizimin e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” të tilla si: auditorët, laboratorët, studiot, ambientet e shërbimit etj. dhe konstaton që ato janë të pajisura me mjete të tilla si kompjuterë, software profesionalë, qasje në literaturë, mundësi shumëfishimi etj. të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><i>Aneksi Nr.102; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në RVB thuhet: <i>në të gjitha ambientet mësimore të institucionit ka pajisje të tilla si projektues video, kompjuterë, internet të cilat janë funksionale.</i> Gjatë vizitës në UMT, GVJ konstatoi që të gjitha këto mjete (pajisje) ishin në dispozicion të studentëve.</p> <p>Po kështu GVJ vizitoi edhe laboratorët e institucionit të vëna në dispozicion edhe të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” si laborator i materialeve të ndërtimit, laborator i shkencave të natyrës, laborator i gjeoteknikës, laborator i informatikës dhe ai multifunksional, laborator i GIS dhe topografisë etj. Të gjithë këto laboratorë ishin të pajisur me pajisjet dhe teknologjitë në shërbim të procesit të mësimdhënies dhe atij të kërkimit shkencor. Në laboratorin e gjeoteknikës, i cili në mënyrë specifike i shërbente PS Msc në “Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile, GVJ pa edhe aneksin CPT, i cili shërben për evidentimin e karakteristikave të truallit në të cilin do të ndërtohet dhe, duke qenë i vetmi në Shqipëri, përdorej jo vetëm për aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” por edhe për studime për të tretët.</p> <p><i>Dosja e vetëvlerësimit; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vizitoi ndër të tjerë edhe laboratorin e informatikës dhe atë multifunksional dhe konstatoi që ato ishin të pajisur me kompjuterë të përshtatshëm dhe kishin të instaluar si programet standarde Microsoft ashtu edhe programe profesionale të lidhura me përdorimin e teknologjive bashkëkohore të fushës së ndërtimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.107; Aneksi Nr.108; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, EV 107 dhe vizitën në institucion konstaton që UMT, kryesisht me kapacitetet që zotëron (laboratorë, studio) por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera (kryerjen e praktikave mësimore, internshipet) garanton mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 50

përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<i>Aneksi Nr.107; Aneksi Nr.108; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi bibliotekën e “Universitetit Metropolitan Tirana”, e cila ofronte kushte për qasje të barabartë e pa pagesë për të gjithë studentët. Biblioteka ishte e pajisur me PC, ku mundësohej përdorimi i literaturës elektronike pa kufizim nga studentët si dhe i programeve kompjuterike.</p> <p>Referuar RVB, Rregullores së UMT, rregullores së bibliotekës dhe takimeve të zhvilluara, rezultojnë se:</p> <p>Biblioteka e UMT ofron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës si me personel ashtu edhe online. Bazuar në rregulloren e UMT-së biblioteka shkencore e Universitetit është bibliotekë publike, që mund të përdoret edhe nga lexues të tjerë. Ajo ka në fondin e saj tekste mësimore bazë si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj.</p> <p>Biblioteka kryen digjitalizimin e skedarëve si dhe shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda e jashtë vendit.</p> <p><i>Aneksi Nr.107; Aneksi Nr.108; Aneksi Nr.109; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Biblioteka e UMT ka në dispozicion të studentëve të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile, tekste mësimore të hartuara nga pedagogët e tij si dhe nga pedagogët më me emër të universiteteve të tjera në vend. Në bibliotekë ka rreth 758 tituj librash si dhe një numër të konsiderueshëm revistash shkencore. Po ashtu, edhe leksionet e shkruara zënë vend të konsiderueshëm për lëndët dhe kurrikulat e reja. Përpjekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore. Librat janë <i>de facto</i> në dispozicion dhe numri i kopjeve është i mjaftueshëm, në raport me numrin e studentëve të regjistruar.</p> <p><i>Aneksi Nr.109; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<p>“Universiteti Metropolitan Tirana” ofron aplikacionin “edu4school”. Nëpërmjet këtij aplikacionit studentit i mundësohet qasja në leksione dhe materialet e ndryshme didaktike që janë në përputhje me syllabuset lëndore të Universitetit dhe tekste bashkëkohore. Studentet konsultohen me leksionet në kohë reale. Ata kanë qasje edhe në adresa online të cilat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 51

	<p>shfrytëzohen si biblioteka elektronike të tilla si:</p> <p>www.thefreelibrary.com www.gutenberg.org www.cobis.al www.reatprint.com etj</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që UMT është në përfundim të lidhjes së marrëveshjes me RASH për qasje në bibliotekën online https://ulibrary.rash.al</p> <p><i>Aneksi Nr.109; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstatoi që ajo ishte e pajisur me programe kompjuterike që qaseshin të gjithë fondin e bibliotekës dhe mundësonin shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><i>Aneksi Nr.109; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Në RVB thuhet që: <i>nga akreditimi i mëparshëm institucionit i rekomandohet të pasurojë bibliotekën me tituj të literaturës bazë dhe ndihmëse për PS "Msc në Inxhinieri Ndërtimi".</i> Në përmbushje të këtij rekomandimi GVJ informohet që ky rekomandim është përmbushur plotësisht pasi është sjellë e gjithë literature bazë dhe ndihmëse e programuar në syllabuset e lëndëve. Po kështu GVJ konstaton që UMT planifikon shtimin e zërave të literaturës në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të PS, duke bashkëpunuar ngushtësisht me personelin akademik në plotësim të nevojave dhe rekomandimeve të tij.</p> <p><i>Aneksi Nr.109; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	<p>Në RVB dhe në EV 109 si dhe gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstaton që biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në orët 08.30 deri në 20.30 (nga e hëna deri të premten) dhe nga ora 09.00 deri në orën 13.00.</p> <p>Nga pyetjet që iu drejtuan studentëve në takimin me ta, GVJ mësoi që ata ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës.</p> <p><i>Aneksi Nr.109; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me	Nga dokumentacioni i DVV, takimet me stafin akademik, studentët, stafin administrativ, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana, përdor dhe zhvillon vazhdimisht sistemet e informimit. UMT disponon sistemin e tij funksional <i>edu4schools</i> , të përshtatur me të gjitha elementet e specifikat

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 52

<p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>që ka UMT dhe programet që ofron.</p> <p>GVJ hyri në këtë sistem dhe u njoh konkretisht me disa nga rubrikat e tij.</p> <p>Gjithashtu referuar RVB dhe takimeve të zhvilluara, GVJ mësoi që UMT është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) dhe QSHA. Nëpërmjet platformave që ofrojnë këto struktura realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UMT-së, si dhe matricullimi i studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UMT-ja.</p> <p>Gjithashtu, UMT përdor shërbimet e ASCAL Management System (AMS) nëpërmjet të cilit administrohen dhe menaxhohen të gjitha informacionet elektronike që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale.</p> <p>Institucioni, menaxhon një cikël të plotë të një studenti: regjistrimin, vlerësimet e studentit deri në diplomim, transferimin e studimeve të studentit, pagesat etj, në format hard copy dhe elektronik (<i>nëpërmjet sistemit edu4schools</i>).</p> <p><i>Aneksi Nr.43;Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.45; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Faqja zyrtare e UMT, pasqyron veprimtarinë administrative, institucionale, akademike, kulturore e sociale, jep informacion lidhur me dokumentet rregullative të institucionit, vendime të Senatit Akademik (miratim kriteresh, kuota, afate aplikimi regjistrimi të studentëve etj.), ciklet dhe programet e studimit, organograma, njoftime/thirrje për projekte etj. Në faqen e UMT, informacionet që lidhen me programin e studimit, planin mësimor, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë në dy gjuhë: gjuhë shqipe dhe angleze</p> <p>Rrjetet sociale, janë një tjetër mënyrë komunikimi që përdor institucioni.</p> <p>Komunikimi i brendshëm kryhej nëpërmjet postës elektronike me domain të institucionit @umt.edu.al, me të cilin është pajisur i gjithë personeli akademik, ndihmësakademik, personelit administrativ, si dhe studentët. GVJ e testoi funksionimin e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe e gjeti atë funksional.</p> <p><i>Aneksi Nr.43;Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.45; RVB; Shënimet e vizitave UMT; www.umt.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha metodat e përdorura të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacionit administrohen nga personi përgjegjës i sektorit të teknologjisë dhe informacionit në nivel rektorati si dhe nga drejtoria e komunikimit, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e tij.</p> <p>Në UMT ka rrjet të brendshëm të lidhur me internet për stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët.</p> <p>Institucioni ka siguruar për punonjësit akademikë dhe jo akademikë infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, si pajisje kompjuterike dhe shërbime interneti, pajisje të tjera të rëndësishme si</p>

	printer, fotokopje, skaner, etj. <i>Aneksi Nr.43;Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.45; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i>								
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton që sistemi edu4schools përmbush kërkesat për komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Po ashtu rrjeti i brendshëm (Intranet) që lidh me internet stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët është një rrjet shumë i dobishëm për shkëmbime edhe konfidenciale, të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe administrativ. <i>Aneksi Nr.43;Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.45; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i>								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Si sistemi edu4scholls, sistemi intranet, domain @umt.edu.al ashtu edhe rrjetet sociale të cilat kontribuojnë në menaxhimin e informacionit në UMT garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësojnë raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. <i>Aneksi Nr.43;Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.45; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i>								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	GVJ konsultoi faqen zyrtare ta UMT (https://umt.edu.al/) ku afishohen të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme dhe konstatoi që ato publikohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. https://umt.edu.al/								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UMT planifikon fonde të mjaftueshme për programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, ku parashikohet mbështetja financiare e nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi . UMT harton raportin financiar të përvitshëm.. Burimet e financimit të UMT janë: fondet dhe kontributet e themeluesve, të ardhurat nga tarifa e shkollimit që paguan çdo student në bazë të tarifave të miratuara, të ardhurat nga projektet e fituara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të ardhurat nga shërbime për të tretë të ofruara nga UMT. Referuar RVB, veprimtaria ekonomike e UMT pasqyrohet në dokumentacionin financiar të detyruar për t’u plotësuar dhe dorëzuar në organet e tatim-taksave sipas legjislacionit financiar në fuqi. Administratori i UMT përgjigjet për realizimin e planit financiar dhe raporton në Bordin e Lartë Drejtues për veprimtarinë ekonomike-

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 54

	<p>financiare.</p> <p><i>Aneksi Nr.118;Aneksi Nr.128; Aneksi Nr.129; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në RVB thuhet: Plan i financimit të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e qasjen në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. GVJ konsultoi dokumentacionin shoqërues, u interesua të dijë situatën lidhur me pagesat e personelit, masën e financimit të kërkimit shkencor, gjendjen dhe pajisjet në infrastrukturë. Ai gjithashtu u interesua të dijë procedurën për hartimin e projekt buxhetit. Në përfundim GVJ konstatoi që ky kriter plotësohet.</p> <p><i>Aneksi Nr.118;Aneksi Nr.128; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në EV 129 është paraqitur “Raport i Audituesit të pavarur mbi pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën ushtrimore 1 janar 2020 deri më 31.12.2020”. Në këtë dokument përmbahet një pasqyrë e hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët dhe ndarjen e këtyre burimeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.129; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Lidhur me dokumentacionin e raporteve financiare për tri vitet e fundit, GVJ konsultoi EV 118 dhe, gjatë vizitës në UMT, u interesua për procedurën e monitorimit të aktivitetit dhe treguesve financiarë. Ai mësoi që Bordit të Administrimit të UMT i raportohet periodikisht nga zyra e financës mbi menaxhimin financiar. UMT bën një analizë të përgjithshme të kostove ku përfshihen shpenzimet për mësimdhënie, pagat e stafit mbështetës administrativ, pagesat për qiranë, energjinë elektrike, telefonat, internetin, për pajisjet si kompjuterë, IT, pajisje laboratorike, blerja e licencave për programet kompjuterike, tarifat e akreditimit, bibliotekën elektronike etj dhe mbi këtë bazë planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p><i>RVB; EV-118-Shpenzimet dhe te ardhurt FIA në 3 vitet e fundit_Tab.Nr.10.pdf; EV-128-Buxheti i UMT_FIA (përocedura e hartimit dhe miratimit per 2019.pdf; Tabela 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.pdf; Shënimet e vizitave UMT;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të</p>	<p>Mbështetur në analizën e kostove si më sipër, UMT bën bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ky bilanc bëhet për çdo PS. Më tej, në funksion të nevojave dhe prioriteteve bëhet planifikimi i blerjeve dhe kryerja e tyre. GVJ u interesua lidhur me gjendjen financiare duke u referuar edhe tek asetet disponuese dhe konstaton plotësimin e këtij</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 55

ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	kriteri. <i>Aneksi Nr.128; Aneksi 108; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UMT është përgjegjëse për përcaktimin e kuotave dhe kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe, për këtë qëllim, ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatore.</p> <p>Në këtë kuadër, pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit https://umt.edu.al/.</p> <p>Kriteret specifike të pranimit dhe numri i kuotave në programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile propozohen nga Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit dhe miratohen nga Dekanati i FIA. Në planifikimin e kuotave të pranimit për vit akademik, merren në konsideratë kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të UMT. Pas miratimit të tyre në Senatën akademik të UMT-së, përcillen për certifikim nga MASR.</p> <p>I gjithë informacioni i mësipërm, bëhet publik në faqen zyrtare të UMT dhe në rrjetet sociale të universitetit, veçanërisht kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi. Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë. Prej vitesh UMT, nëpërmjet komisioneve <i>ad-hoc</i> të përbëra me përfaqësues nga çdo fakultet dhe sistemeve informatike që përdor, ka zhvilluar procedura të drejta të përzgjedhjes së studentëve që regjistrohen në ciklin e parë të studimeve dhe në ciklin e dytë.</p> <p>Regjistrimi i studentëve, ecuria për gjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara e të bëra publike.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.3; Aneksi 30; aneksi Nr.31; Aneksi Nr.34;</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 56

	<i>Aneksi Nr.35; Aneksi Nr.36. www.umt.edu.al; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i>			
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi dokumentacionin e administrimit, procedurat, rregulloret etj, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Ai u informua që studentët, personalisht ose nëpërmjet qeverisë studentore, mund të gjejnë informacionin e duhur në fakultet, departamente dhe në çdo strukturë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ai mësoi që në përputhje me aktet rregullative në fuqi, institucioni e kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar dhe, në bashkëpunim me Fakultetet e UMT, me KS dhe zyrën e karrierës organizojnë aktivitete informuese për kandidatët apo familjarë të tyre në mjediset e UMT. Në këto aktivitete bëhen prezantime rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi kontaktet e nevojshme, njohjen me të gjitha ambientet fizike të fakultetit apo të universitetit. Guida e studentit është material që ka informacionin e nevojshëm që duhet të ketë studenti në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në FIA.</p> <p><i>Aneksi Nr.78; Aneksi Nr.79; Aneksi Nr.80; Aneksi 104; aneksi Nr.105; www.umt.edu.al; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i ofruar si dhe nga takimi me studentët, GVJ mësoi që ata i njihnin dhe njëkohësisht për ta ishin të aksesueshme kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</p> <p>Në këtë kuadër organizoheshin aktivitete të tilla si: Dita e informimit, Panairi i Punës, Për një ditë student në UMT si dhe çdo student pajisej me "Guidën e studentit". Nga konsultimi i faqes zyrtare të UMT del që ato janë të aksesueshme edhe nga publiku.</p> <p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ konsultoi dokumentacionin lidhur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve dhe konstatoi që kriteri bazë është ai i notës mesatare. Ky kriter për studentët e PS "Msc në Inxhinieri Ndërtimi", varej nga oferta vjetore, kapacitetet institucionale si dhe profili i kërkuar.</p> <p><i>Aneksi Nr.30; Aneksi Nr.87; Aneksi Nr.36; www.umt.edu.al; RVB; Shënimet e vizitave UMT; Aneksi Nr.62; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit https://umt.edu.al/, përpara fillimit të çdo viti akademik, UMT udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi". Po kështu këtij qëllimi i shërbejnë edhe aktivitetet e posaçme të cituara më lart si dhe informacionet e posaçme që japin Zyra e Këshillimit të Karrierës, ajo e Shërbimit ndaj Studentit etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.30; Aneksi Nr.87; Aneksi Nr.36; www.umt.edu.al; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
Shkalla e përmbushjes	Nuk përmbushet	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 57

së standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Sa i përket informacionit që vë në dispozicion UMT për kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, GVJ konstatoi që këto informacione i vihen në dispozicion studentit nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në faqen zyrtare të institucionit dhe nëpërmjet akteve normative institucionale. Rol të rëndësishëm luajnë edhe këshillat studentorë, shënimet që mbahen nga stafi akademik, stafi ndihmës akademik, sekretaria mësimore si dhe sistemi edu4schools. Përdorimi i të gjitha këtyre burimeve dhe shfrytëzimi i të gjitha këtyre mundësive bën që informacioni mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve të jetë i plotë dhe i hollësishëm.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.79; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Nëpërmjet akteve rregullatore të UMT si dhe informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, UMT informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Gjatë takimeve në UMT, GVJ mësoi se këto kriterë ishin të qarta dhe studentët kishin përfituar duke u regjistruar pa pengesa edhe në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.30; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.79; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton që sistemi i menaxhimit edu4schools funksionon për t’u dhënë studentëve saktë dhe në kohë të gjitha informacionet lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Mundësi të tjera jepen nga përdorimi i faqes zyrtare të UMT, komunikimet zyrtare në domain-in @umt.edu.al, interesimit të drejtpërdrejtë të studentëve në Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe asaj të Mbështetjes së Studentëve etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.43; Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.45; Aneksi Nr.79; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në UMT, në takimet me studentët dhe personelin akademik GVJ mësoi se Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit jep informacione lidhur me mënyrën e punimit të tezës së diplomës si për formatin e shkrimit ashtu edhe për organizimin e përgjithshëm të saj. Në mbështetje të këtij procesi japin informacione edhe dekanati i FIA, po ashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p><i>Aneksi Nr.64; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 58

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri UMT organizon aktivitete të tilla si “Dita e Informimit”, “Për një ditë student në UMT”, “Panairi i punës”, boton dhe shpërndan “Guidën e studentit” si dhe informon nëpërmjet faqes zyrtare të UMT-së https://umt.edu.al/</p>		
<p><i>Aneksi Nr.36; Aneksi Nr.79; RVB; Shënimet e vizitave UMT</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” studenti informohet nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare https://umt.edu.al/, komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta më “Sekretarinë Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, koordinatori i departamentit etj. Nga të gjitha këto burime ai njihet me kohëzgjatjen e studimeve në “Msc Inxhinieri Ndërtimi” (2 vjet/ 120 ECTS), ngarkesën në kredite vjetore (60 ECTS), Kurrikulën, syllabuset.</p> <p><i>Aneksi Nr.36; Aneksi Nr.54; Aneksi 56; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese studentët e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” informohen nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare https://umt.edu.al/, komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta më “Sekretarinë Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, koordinatori i departamentit etj. Nga të gjitha këto burime ai informohet që në PS “Msc Inxhinieri Ndërtimi” zhvillohen 15 lëndë/module gjatë gjithë kohëzgjatjes, duke përfshirë këtu edhe praktikën si dhe tezën e diplomës. Po ashtu ai informohet se PS ofron edhe 4 lëndë me zgjedhje. Tek përmbajtja e çdo syllabusi ai informohet mbi tipologjinë, llojin dhe kodin e lëndës. Po ashtu atij i jepet emri i titullarit të lëndës dhe adresa elektronike e tij. Më tej i bëhet i njohur kodi i etikës dhe objektivat e të nxëniet duke vazhduar me temat që do zhvillohen dhe format e kontrollit të dijes. Në fund ai informohet për literaturën bazë dhe atë të rekomanduar.</p> <p><i>Aneksi Nr.14; Aneksi Nr.54; Aneksi 56; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun</p>	<p>Mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështetjen që jep institucioni për orientimin drejt dhe në tregun e punës, studenti informohet po ashtu nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare https://umt.edu.al/, komunikimi në domain-in</p>

Adresa: “Ruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 59

e punës.	<p>@umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarinë Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, Zyrën Alumni, koordinatorin e departamentit etj. Rol të veçantë në këtë drejtim marrin Zyra e Këshillimit ta Karrierës”, Zyra e Mbështetjes së Studentëve” dhe Zyra Alumni. Në takimin me studentët GVJ mësoi se prej këtyre zyrave marrin shërbimin e duhur. Po kështu në takimin me përfaqësues të tregut të punës dhe të diplomuarit në këtë PS, GVJ u njoh me ofertën e tyre për të ndihmuar sa më shumë në punësimin e kontingjenteve që mbarojnë PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” dhe kontributin që japin ata në sigurimin e Internship-eve. Këta të fundit na informuan gjithashtu se institucioni mban lidhje të vazhdueshme me ta.</p> <p><i>Aneksi Nr.43; Aneksi Nr.44; Aneksi 82; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit në UMT studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjatë takimit me studentët ata pohuan disponimin e këtij informacioni dhe lehtësitë e qasjen në të.</p> <p><i>Aneksi Nr.43; Aneksi Nr.44; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>GVJ konstatoi që në UMT sistemi i informacionit të brendshëm funksionin mirë në të gjitha format e organizimit të tij, kryesisht në platformën edu4schools, faqen zyrtare https://umt.edu.al/, komunikimin në domain-in @umt.edu.al, platformën e mësimit online GoToMeeting. Në të gjitha këto forma menaxhimi informacioni është lehtësisht i arritshëm dhe shterues.</p> <p><i>Aneksi Nr.43; Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.48; Aneksi Nr.49; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	<p>Gjithë sistemi i brendshëm i menaxhimit në UMT, i përmendur më lart administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor edhe të studentëve të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”. Tek EV 87 gjendet i gjithë informacioni që gjenerohet për dosjen e një student.</p> <p><i>Aneksi Nr.43; Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.48; Aneksi Nr.49; Aneksi Nr.87; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve	Në përmbushje të detyrimeve ligjore për të administruar, ruajtur dhe arkivuar çdo dokument dhe informacion zyrtar që lidhet me aktivitetin e vet edhe UMT e ka sanksionuar këtë detyrim në rregullimet ligjore të aktivitetit të tij. Për ruajtjen e dokumentacionit si në letër ashtu edhe medium elektronik, UMT ka sektorin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 60

<p>në programin e studimit.</p>	<p>Protokoll-arshivës, Dokumentet e arkivuara (materialet mësimore e ato të kërkimit shkencor si dhe i gjithë shkresimi administrativo-burokratik) ruhen në dosje të veçanta të ndara në vite. Për këtë institucioni ka hartuar rregullore të veçantë.</p> <p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ u interesua për ruajtjen e dokumentacionit dhe konstatoi që institucioni ruante dhe administronte të gjitha statistikak vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. I gjithë dokumentacioni i arkivuar ishte i protokolluar dhe inventarizuar.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.87; Aneksi Nr.95; Aneksi Nr.114; RVB; Shënimet e takimeve; www.umat.edu.al</i></p>																																								
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>GVJ iu vunë në dispozicion regjistrat themeltarë që gjendeshin tek sekretaria mësimore. Këto regjistra përmbanin të gjitha të dhënat që kërkohen ligjërisht dhe aty evidentohet qartë numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi", tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Të gjithë ishin të pajisur me numër matrikulimi. Po ashtu edhe tek dosja e studentit ishin të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar.</p> <p><i>Aneksi Nr.87; RVB; Shënimet e takimeve; www.umat.edu.al</i></p>																																								
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>UMT, nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit disponon të gjitha të dhënat për studentët, të cilat përditësohen nga profili individual i përdoruesit. Të drejtën për të gjeneruar statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS, transferimet, largimet dhe të diplomuarit për çdo vit e kanë sekretaria mësimore dhe administratori i sistemit në UMT. GVJ konstatoi që të gjitha të dhënat disponohen nga institucioni dhe përdoren prej tij si bazë të dhënash.</p> <p>Në regjistër hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimit deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Të dhënat për periudhën 4 vjeçare, nga akreditimi i mëparshëm janë si më poshtë:</p> <p><u><i>Profili Inxhinieri Strukturash</i></u></p> <table border="1" data-bbox="555 1411 1343 1635"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Per here të parë</th> <th>Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>22</td> <td>3</td> <td>6.79</td> </tr> <tr> <td>2018 -2019</td> <td>26</td> <td>2</td> <td>6.10</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>24</td> <td>9</td> <td>6.48</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>25</td> <td>9</td> <td>6.45</td> </tr> </tbody> </table> <p><u><i>Profili Inxhinieri Infrastrukturë transporti</i></u></p> <table border="1" data-bbox="555 1713 1343 1926"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Per here të parë</th> <th>Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>13</td> <td>2</td> <td>6.48</td> </tr> <tr> <td>2018 -2019</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>6.40</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>11</td> <td>2</td> <td>6.53</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>14</td> <td>4</td> <td>6.48</td> </tr> </tbody> </table>	Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare	2017-2018	22	3	6.79	2018 -2019	26	2	6.10	2019-2020	24	9	6.48	2020-2021	25	9	6.45	Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare	2017-2018	13	2	6.48	2018 -2019	3	2	6.40	2019-2020	11	2	6.53	2020-2021	14	4	6.48
Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare																																						
2017-2018	22	3	6.79																																						
2018 -2019	26	2	6.10																																						
2019-2020	24	9	6.48																																						
2020-2021	25	9	6.45																																						
Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare																																						
2017-2018	13	2	6.48																																						
2018 -2019	3	2	6.40																																						
2019-2020	11	2	6.53																																						
2020-2021	14	4	6.48																																						

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 61

	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit në UMT është i sigurt. GVJ kërkoi lejen për tu futur në platformën edu4schools dhe konstatoi që kjo platformë menaxhimi është e sigurt. Gjithashtu gjatë takimit me studentët u informuam që të dhënat janë lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar.</p> <p><i>Aneksi Nr.43; Aneksi Nr.44; Aneksi Nr.73; Aneksi Nr.87; RVB; Shënimet e takimeve; www.umt.edu.al</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve në institucion rezultoi se UMT-ja periodikisht harton dhe analizon raporte të detajuara mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Sekretaria mësimore bën raportet mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Shërbimit ndaj Studentit, informon lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit. Drejtorja e komunikimit dhe marrëdhënieve me jashtë, është njësi që analizon punësimin e studentëve të diplomuar sipas programeve të studimit, ofron shërbim të plotë të menaxhimit të karrierës, mbështetje në kërkimet e punësimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, bën njoftime punësimi periodike, këshillim të personalizuar të karrierës si dhe jep ndihmë konkrete rreth mënyrës së kërkimit të punës dhe përgatitjes së CV dhe dokumenteve të tjerë të rekrutimit.</p> <p><i>Dosja e vetëvlerësimit; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në UMT, studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të institucionit sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.</p> <p>Referuar RVB, dokumentacionit në DVV si dhe në takimet e zhvilluara, GVJ konfirmon se studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatit Akademik, në NjBSC dhe në Këshillin e Etikës mbështetur në statutin e UMT-së dhe rregulloret e ndryshme nëpërmjet të cilave është garantuar përfaqësimi i studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.12; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin</p>	<p>Në UMT, funksionon Këshilli studentor i UMT (KS UMT), i cili është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. KS ka rregulloren e tij, ka komunikim institucional me strukturat e tjera në UMT për të përçuar në mënyrë e drejtpërdrejtë e për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Aktivitetet e KS mbështeten në forma të ndryshme nga ana e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 62

<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.12; Aneksi Nr.105; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Studentët e UMT-së, shprehin mendimet e tyre për procesin mësimor dhe për aspekte që lidhen konkretisht me studentin, nëpërmjet vlerësimeve semestrale, takimeve informale, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentit etj. Në këtë aktivitet përfshirës mbahen parasysh ngarkesa akademike e studentëve në programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton që institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga departamenti/fakulteti/NJSBC, si gjatë diskutimit të planeve mësimore në fazat e miratimit të tyre ashtu dhe në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës. Në optikën e studentëve hyn edhe gjetja e problematikave, për të cilat ata kërkojnë apo propozojnë zgjidhje më të drejtën që sanksionohet në aktet rregullative të institucionit. Në dokumentet rregullative në nivel universiteti, fakulteti dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile është parashikuar procesi i transferimit të studimeve (njohje të pjesshme ose e plotë e studimeve) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për këtë aspekt.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.12; Aneksi Nr.58; Aneksi Nr.105; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u informua që UMT garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> <p><i>Aneksi Nr.58; Aneksi Nr.12; Aneksi Nr.105; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, UMT zbaton rregullat e përcaktuara në rregulloren e UMT dhe në rregulloren e provimeve. Nëpërmjet procedurave të sanksionuara në këtë dokumentacion synohet të sigurohet ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë këtu mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë dhe pedagogut përgjegjës. Në këtë kontekst, GVJ evidenton faktin që UMT në kuadër të projektit me AADF, po implementon sistemin <i>cleanscore</i>, për korrigjimin e provimeve në formë elektronike</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.120; Aneksi Nr.58; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Referuar DVV si dhe protokollit të vizitave në UMT (takimi me personeli akademik) GVJ konstaton që edhe personeli akademik i angazhuar me PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. Ky aktivitet pasqyrohet në analizën vjetore të fakultetit që bëhet periodikisht çdo vit (EV 73). Në këtë analizë referohen arritjet në aktivitetin shkencor e botues dhe përcaktohen politikat e kërkimit shkencor. <i>Aneksi Nr.73; Aneksi Nr.93; RVB Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Nga shqyrtimi i RVB dhe nga protokollit i takimeve në UMT del që është punuar për të rritur mundësinë e bashkëpunimit me institucione partnere brenda e jashtë vendit. GVJ konstaton që nga këto bashkëpunime ka përfutur jo vetëm Personeli Akademik por edhe studentët. <i>Aneksi Nr.22; Aneksi Nr.93; RVB Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Në takimin me PA, pyetjes:- A keni përfshirë studentë në punën tuaj studimore, një pedagog iu përgjigj që kam përfshirë 2 studentë të cilët janë angazhuar për krijimin e bazës së të dhënave. Referuar RVB pohohet që studentët inkurajohen të përdorin dhe aplikojnë metoda dhe metodologji inovative të cilat u krijojnë atyre mundësi të përfshihen në kërkimin shkencor. Vitet e fundit fokusi i punës së Fakultetit/ departamentit ka qenë angazhimi i studentëve në programe shkëmbimi dhe mobiliteti. <i>Aneksi Nr.22; Aneksi Nr.26; Aneksi Nr. 75; Aneksi Nr.102; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Pyetjes së GVJ në takimin me PA “Ka praktika ku UMT ju motivon për të botuar në revista shkencore?” një pedagog iu përgjigj në mënyrë pohuese. Një pedagog tjetër pohoi që ka 10 botime jashtë dhe në këtë aktivitet është mbështetur nga institucioni. <i>Aneksi Nr.75; Aneksi Nr.110; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Gjatë takimit me studentët ata thanë që personeli akademik i motivon dhe mbështet studentët të angazhohen me studime sidomos në kuadrin e realizimit të temave të diplomave. <i>Aneksi Nr.59; Aneksi Nr.91; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	GVJ konstatoi që stafi akademik ishte përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët që kanë në udhëheqje duke vlerësuar si performancën ashtu dhe progresin e tyre. Këtë angazhim të pedagogëve e pohan edhe studentët gjatë takimit me to. <i>Aneksi Nr.59; Aneksi Nr.91; RVB; Shënimet e takimeve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Referuar RVB gjendet që FIA ka realizuar kryesisht bashkëpunime me njësitë kryesore ta UMT si dhe me IAL partnere. Këto bashkëpunime kanë mundësuar ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të PA. Në UMT është synuar dhe realizuar pjesëmarrja e studentëve në ekspertiza si ato të vlerësimit të strukturave ndërtimore tek banesat e dëmtuara nga tërmeti po ashtu dhe tek shfrytëzimi i kapaciteteve kërkimore të ILA-ve partnere etj. <i>Aneksi Nr.25; Aneksi Nr.26; Aneksi Nr.27; Aneksi Nr.82; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Në shqyrtimin e kurrikulës mësimore konstatohet që studentët nëpërmjet implementimit të metodave të kërkimit nga personeli akademik sigurojnë vijueshmëri dhe përgatitje edhe për ciklin e tretë të studimeve. <i>Aneksi Nr.54; Aneksi Nr.56; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	GVJ vlerëson që konceptimi dhe ndërtimi i kurrikulës të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” është projektuar me ambicien për të përgatitur studentët me kompetenca të tilla që ata të përfshihen në projekte kërkimore vendës dhe të huaj. Dëshmi e kësaj ambicie janë rezultatet e arritura nga studentët në kuadrin e programeve të mobilitetit. <i>Aneksi Nr.54; Aneksi Nr.56; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Me politikat e realizimit të marrëveshjeve me institucione partnere të huaj, UMT kërkon integrimin e kërkuesve të huaj në punën e vet kërkimore shkencore <i>Aneksi Nr.25; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	GVJ shqyrtoi evidencat e DVV 3, 23 dhe 27 dhe konstaton që UMT ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. Mobiliteti dhe shkëmbimi kryhen në kuadër të programit Erasmus+, KA 107 me 19 institucione partnere si dhe në kuadër të programit S.E.M.IN.A.RE si pjesë e unionit të universiteteve mesdhetare me 2 institucione partnere. <i>Aneksi Nr.3; Ankesi Nr.23; Aneksi Nr.27; RVB; Shënimet e takimeve.</i>
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Në evidencën EV 27, GVJ gjen që UMT, për të rritur profilin ndërkombëtar, ka ftuar për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore nga institucionet partnere të huaja. Nga EV 72 GVJ mëson që për periudhën tetor 2019 deri në nëntor 2020 janë mbajtur 4 leksione të hapura nga autoritete shkencore të ftuara nga UMT si dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 65

	<p>është marrë pjesë online në një aktivitet të organizuar nga Universiteti Teknik në Pragë në bashkëpunim me një fondacion ku janë ndjekur 9 leksione 5 prej të cilave janë mbajtur nga PA i UMT-së.</p> <p>Në takimin me përfaqësues të Zyra së marrëdhënieve me jashtë na u tha që së shpejti pritet të vijë një pedagog francez si dhe një student franceze me afat qëndrimi 3 mujor. <i>Aneksi Nr.72; Aneksi Nr.27; RVB; Shënimet e takimeve;</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ, referuar RVB, mëson që UMT ka të ngritur një sistem funksional informacioni për të përçar tek studentët gjithë çfarë atyre u nevojitet në lidhje me PS: procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, rregulloren e provimeve, procedurat që lidhen me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor etj. Në rang institucioni funksionon dhe një zyrë e posaçme e informimit të studentëve dhe e publikut që në organogramë quhet Drejtoria e Komunikimit. Informacionet shpërndahen si në hard copy ashtu edhe në format elektronik. Informacionet merren edhe nga faqja zyrtare e institucionit si dhe koordinorët e programit. Po ashtu studenti informohet në kuadër të departamentit për organizimin e mësimin, aktivitetet e ndryshme, diplomimin, ecurinë e procesit mësimor etj. Në strukturën organike të njësisë kryesore, informacione për studentët japin edhe Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Mbështetjes së Studentëve etj. Aktiviteti informues i këtyre shërbesave rregullohet sipas parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore të UMT. Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, NjsBC, Zyrës së Kurrikulës e Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrës së Shërbimit të Studentëve, Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrës së Hartimit e Menaxhimit të Projekteve. Në të gjitha këto takime GVJ u informua për aktivitetin e tyre në shërbim të studentëve.</p> <p><i>Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.95; Aneksi 77; RVB; Shënimet e takimeve; www.umd.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin</p>	<p>UMT ofron shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Nga kjo zyrë merren informacione në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.77; RVB; protokollin e takimeve; www.umd.edu.al</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 66

e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Gjatë vizitës në UMT në takimin me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, GVJ konstatoi që kjo zyrë ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. <i>Aneksi Nr.77; RVB; Shënimet e takimeve; www.umat.edu.al</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, neni 103 përcaktohet “ <i>Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për SBC. Struktura dhe funksionimi i NjSBC përcaktohen në statutin e IAL</i> ”. Në zbatim të këtij ligji, GVJ konstaton që UMT e ka ngritur dhe e ka funksionuese NjSBC. Gjithashtu ky institucion ka edhe një zv Rektor që përgjigjet për SBC.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në plotësim të kriterit 1, GVJ konstaton që institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Gjatë takimit me NjSBC u konfirmua që në përbërje të saj ishin dhe një përfaqësues nga studentët dhe një ekspert i jashtëm. <i>Ligji për arsimin e lartë; .Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; RVB; Shënimet e takimeve.</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 67

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Referuar RVB mësohet që krahas SBC përdoret edhe SJC (Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë. Sa i përket SBC institucioni e ka të ngritur dhe funksional atë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Për sigurimin nga jashtë të cilësisë në UMT janë bërë si akreditime institucionale ashtu edhe akreditime për PS. Nëpërmjet tyre janë dhënë vlerësime SWOT, të cilat e kanë inkurajuar institucionin të punojë për realizimin e rekomandimeve. GVJ konstaton që rekomandimet e akreditimit të fundit për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” janë konsideruar nga institucioni dhe janë paraqitur në RVB.</p> <p><i>Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.13; Aneksi Nr.8; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Në ndjekje të dinamikës së ecurisë së PS në UMT konstatohet rritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë. Kjo tregon që institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile, në kuadër të SBC-së.</p> <p><i>Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.13; Aneksi Nr.18; Aneksi Nr.8; RVB Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>UMT si IAL ka ngritur njësitë e tij për sigurimin dhe realizimin e cilësisë. Njësia përgjegjëse për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi” është Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Ai jo vetëm organizon konkretisht gjithë aktivitetet e këtij PS por edhe koordinon punën për realizimin sa më cilësor të tij. Në UMT përgjegjësia administrative për SC bie mbi drejtuesin e departamentit dhe koordinatorin e programit. Detyrat e tyre rregullohen me dispozita ligjore. Pasi sigurohen të dhënat ato dërgohen në FIA i cili koordinon aktivitetin për SC me NJSBC. Kjo e fundit mbështetur në rregulloren e saj kryen vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me vlerësimin e jashtëm. Përveç kësaj nga Njësia kryesore, periodikisht kryhen monitorime te procesit mësimor, rezultatet e të cilave analizohen dhe nga këto analiza nxirren përfundime për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.58; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.122; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 68




<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në UMT përdoren mekanizma të tillë si analiza vjetore në rang fakultetesh ku evidentohet cilësia e PA, cilësia e syllabuseve, cilësia e literaturës së përdorur, rezultatet e studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit etj duke hartuar një plan masash për përmirësim e PS edhe në studimet e ciklit të dytë.</p> <p><i>Tabela Nr.21; Tabela Nr.23; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Si metodologji vlerësimi në UMT përdoren “Pyetësorët për vlerësimin e pedagogëve” që plotësohen në fund të çdo semestri. Rol të veçantë merr Bordi i Provimeve i cili vlerëson cilësinë e provimeve dhe përgatit raporte vjetore që ia dërgon për shqyrtim e veprim Komisionit të Përhershëm për SC dhe Senatit. Përdoret si metodologji edhe vlerësimi i performances akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor e projekte.</p> <p><i>Aneksi Nr.58; Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.11; Aneksi Nr.18; Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.68; Tabela Nr.6; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha gjetjet në procedurat dhe metodologjitë për sigurimin e cilësisë u përcillen autoriteteve vendimmarrëse për PS (përgjegjës departamenti/dekan) si dhe organeve kolegjiale (dekanati/senati akademik) të cilët, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore marrin masat përkatëse.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.58; Aneksi Nr.18; Aneksi Nr.68; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e arritura, masat që merren dhe për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Ato paraqiten në senat dhe në Bordin e Administrimit ku diskutohet e miratohet plan i masave me afate të përcaktuara për realizim. GVJ, nisur nga puna e bërë por edhe nga historia e vlerësimeve përkatësisht akreditimeve, gjykon që sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë në PS “Msc Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile ka arritur gjithmonë në rritje.</p> <p><i>Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.71; Aneksi Nr.73; Aneksi Nr.93; Aneksi Nr.115; Aneksi Nr.119; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i</p>	<p>Në arkivin e UMT janë dokumentuar të gjitha proceset e vlerësimeve të PS si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme (akreditime) nga viti 2014-2015 kur është hapur PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile. Në të gjitha rastet konstatohet që konkluzionet e vlerësimeve janë përdorur për të bërë progres në SC. Pra UMT e ka përfshirë këtë informacion në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

<p>arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p><i>Aneksi Nr.13; Aneksi Nr.16; Aneksi Nr.18; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.114; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>UMT për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metodat e mëposhtme të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimin nga NjsBC në nivel institucional • Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit • Vlerësime nga komisione ad-hoc të ngritura nga dekani në bashkëpunim me NjsBC. • Sondazhe, anketime dhe mbledhje informacioni nga studentët • Monitorime nga drejtuesit e departamentit <p>Në të gjitha rastet është marrë parasysh natyra dhe specifika e fushës akademike të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.71; Aneksi Nr.115; Aneksi Nr.119; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton që në UMT në kuadër të vlerësimit, realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim i didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës.</p> <p>Të gjitha këto metoda janë dokumentuar dhe rezultatet e tyre janë përdorur për të realizuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një tregues për këtë janë edhe rezultatet e akreditimeve institucionale e programore.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.71; Aneksi Nr.115; Aneksi Nr.119; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin</p>	<p>GVJ konstaton që në UMT, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes, e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit, institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Të gjitha këto metoda janë dokumentuar dhe rezultatet e tyre janë përdorur për të realizuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Një tregues për këtë janë edhe rezultatet e akreditimeve institucionale e programore.</p>

apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program	<i>Aneksi Nr.71; Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.11; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentet rregullatore të këtij institucioni thuhet se <i>“të gjitha strukturat përbërëse të UMT janë përgjegjëse për SC të PS-ve që ai ofron bazuar në mekanizmat e SC dhe akteve rregullatore”</i>.</p> <p>Synimi kryesor i përcaktuar në këto akte është gjithëpërfshirja e kontribuesve në procesin e mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera akademike. Në këtë kuadër përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen dhe cilësinë e PS <i>“Msc në Inxhinieri Ndërtimi”</i>, me dy profile është <i>“Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit”</i>. Pikërisht kjo njësi përgjegjëse ka ngritur, propozuar, aktivizuar e monitoruar gjithë aktivitetin për SC. Po ashtu fakulteti i FIA ka koordinuar këtë aktivitet, realizimi i të cilit pastaj kërkon gjithëpërfshirje të strukturave të institucionit.</p> <p>GVJ konstaton që SC për PS <i>“Msc në Inxhinieri Ndërtimi”</i>, me dy profile është realizuar me përfshirjen e gjithë aktorëve, të brendshëm e të jashtëm, të interesuar dhe të ngarkuar për këtë proces.</p> <p><i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.50; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.16; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UMT, mbështetur në aktet ligjore (Ligji 50/2015) dhe ato rregullatore ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NjSBC në përbërje të së cilës ka aktorë të brendshëm, studentë dhe aktorë të jashtëm. Të dhënat e kërkuara dhe të siguruara nga kjo zyrë i vihen në dispozicion GVB i cili harton RVB.</p> <p>GVJ i ka konsultuar të gjitha materialet e DVV, ka hartuar protokollin e takimeve në institucion dhe konstaton që aktorët e ngarkuar për SC i kanë ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre.</p> <p><i>Aneksi Nr.1; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve; Ligji për arsimin e lartë</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet</p>	<p>Në shqyrtimin e gjithë materialeve të DVV si dhe në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ gjen që në sigurimin e cilësisë në PS <i>“Msc në Inxhinieri Ndërtimi”</i>, me dy profile është garantuar dhe është realizuar përfshirja e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	njësisë bazë (Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit) dhe kryesore (FIA), përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. <i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në kontrollin, realizimin dhe monitorimin e cilësisë për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile të dhënat e përdorura janë të plota, të qarta dhe të sakta. Këto cilësi të të dhënave u konfirmuan edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion. Kjo dëshmon që përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit ka respektuar integritetin akademik dhe ka shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. <i>Dosja e vlerësimit; RVB; Shënimet e takimeve</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Për krijimin e bazës së të dhënave lidhur me plotësimin e standardeve të cilësisë janë përfshirë edhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me PS. Në grupet e vetëvlerësimit janë përfshirë edhe pedagogë të huaj të angazhuar si PAE në PS si dhe studentë. Po ashtu nga vizita në institucion, GVJ mësoi që janë konsultuar edhe ekspertë të tjerë nga tregu i punës dhe nga partnerët bashkëpunues. Mendimet dhe sugjerimet janë konsideruar jo vetëm duke u përfshirë në RVB por edhe duke u realizuar konkretisht. <i>Dosja e vlerësimit; RVB; Shënimet e takimeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në DVV, gjen që politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. GVJ, gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësues të zyrave të NjSBC dhe asaj të Kurrikulës dhe Cilësisë u njoh me veprimtarinë konkrete të këtyre zyrave dhe konstaton që aktiviteti konkret i tyre synon dhe realizon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Dëshmi e këtij progresi janë edhe rezultatet e akreditimeve si të institucionit ashtu edhe të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile. <i>Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 72

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të zyrave të NjSBC dhe asaj të Kurrikulës dhe Cilësisë, GVJ u informua për të gjitha procedurat që ndiqen nga këto zyra për sigurimin e cilësisë, duke filluar me rishikimin e planeve mësimore, vlerësimin e mësimdhënies nga pedagogët nëpërmjet vizitave në klasa dhe intervistimit të tyre mbi cilësinë e programeve, angazhimin e studentëve nëpërmjet sondazheve mbi zhvillimin e provimeve etj. Në këto zyra shqyrtohej edhe RVB, ndiqej plotësimi i standardeve të kërkuara për akreditimin e programeve, ndërtimi i pyetësorëve, krijimi i sistemit të patronazhit ku pedagogët e vjetër ndihmojnë të rinjtë etj. E gjithë procedura publikohet duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.14; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve</i></p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Gjatë takimit me NjSBC dhe përfaqësuesit e Zyrës të Kurrikulës dhe Cilësisë, GVJ mësoi që i gjithë aktiviteti i tyre organizohet dhe realizohet mbi bazën e një plani periodik, në hartimin e të cilit merren në konsideratë të gjitha problemet e evidentuara nga aktiviteti i mëparshëm me synim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.18; RVB; Shënimet e takimeve</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, proceset e vlerësimit në kuadër të akreditimit të UMT si institucion apo si programe, kanë pasur impakt në ndërgjegjësimin e të gjitha strukturave, personelit akademik dhe studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton që UMT çmon dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit “Msc në Inxhinierinë e Ndërtimit”.</p> <p><i>Aneksi 13; Aneksi Nr.16; Aneksi Nr.8; RVB; Shënimet e takimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile NjSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakulteteve. Takime kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale. Po ashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Grupin e Vetëvlerësimit dhe NjSBC çfarë u mundëson atyre që të përcjellin në mënyrë të vazhdueshme mendimet e tyre mbi problemet e cilësisë dhe të sugjerojnë masa që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të saj. <i>Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.8</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profile: “Inxhinieri Strukturash” dhe “Inxhinieri Infrastrukturë Transporti”, “Universiteti Metropolitan Tirana”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Organizimi i trajnimeve të ndryshme institucionale për pedagogët dhe studentët.
2. Numri i madh i Marreveshjeve të bashkëpunimeve të UMT me institucionet tjera.
3. Planifikimi i ndërtimit të kampusit të ri prej 10.000 m².
4. Institucioni ka krijuar një traditë vlerash në rekrutimin e personelit dhe angazhimin e tij, çfarë konfirmohet me produkte të certefikuara në tregun e punës (80 deri në 100% të kontigjenteve të tij)
5. Kualifikimi shkencor i Personelit Akademik i përgjigjet nivelit të kërkesave që ka institucioni duke përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale dhe duke realizuar objektiva konkrete për kualifikim të mëtejshëm. Ai ka evidentuar zotësi në realizimin e programeve të bashkëpunimit me universitetet partnere dhe cilësi në botimet e referimet e përbashkëta.
6. UMT e trajton personelin e angazhuar në programin mësimor “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile, në mënyrë të tillë që ai ndjehet edhe i shpërblyer edhe i motivuar. Dëshmi e vërtetësisë së këtij pohimi është rekrutimi i personelit akademik cilësor vendas dhe rekrutimi i pedagogëve të huaj.
7. Studentët e këtij institucioni dhe posaçërisht ata të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”, me dy profile kanë në dispozicion të gjitha shërbimet për t’u informuar në kohë e me cilësi. Ata ndjehen të lidhur me tregun e punës dhe të sigurtë për ta kapur atë.
8. UMT gëzon një imazh të mirë për aktivitetin e tij, të fituar edhe nëpërmjet akreditimeve (akreditimet institucionale dhe ato të programeve të studimeve).

Pika të dobta

1. Feedback-u i pa evidentuar nga tregu i punës, për nevojat e përmirësimit eventual të lëndëve, kurrikulës të programit të studimit MSc në “Inxhinieri Ndërtimi”, në dy profilet.
2. Numri i lëndëve mësimore me zgjedhje të programit të studimit është i vogël dhe nuk shkojnë më së miri me profilet, përkatësisht me kompetencat.
3. Në nivelin aktual UMT nuk e realizon plotësisht objektivin e tij për të hyrë i sigurtë në konkurrencën për rekrutim të studentëve të huaj, pasi akoma nuk është bërë universitet dy gjuhësh.
4. Cilësia në hyrje e studentëve nuk është akoma në nivelin e konkurrencës në raport me disa institucione partnere.
5. Ambientet në tërësi, edhe pse funksionale e konkurente, kanë nevojë për përmirësim. Në këtë drejtim realizimi i projektit të institucionit për kampus të ri universitar do të shënonte një përmirësim shumë domethënës.

Rekomandime

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 74

1. Të merret dhe të konsiderohet më mirë feedback-u nga tregu i punës, për të përmirësuar/ndryshuar përmbajtjen e lëndëve mësimore si dhe formatin e lëndëve me zgjedhje.
2. Të ndërmerren hapa konkretë për rritje të kapaciteteve të bibliotekës.
3. Personelit akademik të rregullt të FIA, departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit t'i krijohet mbështetje më e lartë financiare për aktivitete të kërkimeve shkencore.
4. UMT të realizojë sa më shpejt objektivin e tij për t'u bërë plotësisht universitet dygjuhësh
5. UMT të vazhdojë të rrisë kriteret për pranimin e kontigjenteve cilësorë, në mënyrë që të arrijë e të tejkalojë nivelin e konkurrencës;
6. UMT të realizojë në kohë projektin për ndërtimin e korpusit të ri e ta bëjë atë sa më shpejt funksional.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in “Civil Engineering” for two profiles: “Structural Engineering: and “Transport Infrastructure Engineering” of the “Metropolitan Tirana” University”

Strengths and affirmations

1. HEI organize the different trainings for academic staff and students.
2. Numerius of Memorandums and collaborations of UMT with other institutions
3. The planning of the construction of the new campus of 10,000 m².
4. The HEI has established the tradition of values for staff recruitment and his engagement, which is confirmed with the certificated products in market labor (80 up to 100% of his contingents)
5. The scientific qualification of the academic staff responds to the HEI requirements, which fulfilling all contractual duties and realizing concrete objectives for further qualifications. He has evidence of ability in the implementing of program cooperation's with the partner Universities and the quality for the publications and references.
6. The HEI treats the academic staff were ingaded in the study programe of MSc Civil Engineering in the way that it feels motivated and rewarded. Proof of the veracity of this statement is the recruitment of the quality local academic staff and the recruitment of foreign professors.
7. The students of HEI and especially the academic staff of study program of MSc Civil Engineering have all services available to be informed in a time and quality manner. They are connected with the market labor and ready to catch them, based on the experiences of contingents who are finished the study programme.
8. The HEI enjoys a good image of its activity gained also thru the accreditations (institutional accreditations and study programmes)

Weak points

1. The unevidenced feedback from the labor market for the eventual demands of teaching subject's improvement, improvement of curriculum of the study program of MSc Civil Engineering, respektively for two of profiles.

2. The number of elected teaching subject of the study program is lower and do not go best with profiles respectively with the competences.
3. At the current level the HEI does not fully achieve its objective to enrollment the competition for safe recruitment, mainly of foreign students, as it has not yet become a bilingual University.
4. The quality of incoming students is not yet at the level of competition in relation with some of the institucional partners.
5. The entire fascities of HEI even if functional ad competitive, needs to be improved. In this regard, the construction of new university campus would mark a significant improvemenet.

Recommendation

1. Should be taken, and better considered feedback from the labor market, to improve/change the content of courses, as well as the format of electives.
2. To take necessary measurements to be increased the library capacity.
3. To provide the higher financial support to the academic staff of FCA, respectively Department of Civil Engineering members for research activity.
4. As soon as possible, the HEI to achieve its goal of becoming a fully Bilingual University.
5. To continue to increase the criteria for the quality contingency enrollment of students in order to reach and exceed the level of competition.
6. To realise in time the new kampus and to make it functional as soon as possible.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 77